

EQREM ÇABEJ

X

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XV

N

ndal ndalem; ndal! "qëndro në vend"; ndalë f. "ndalim, pushim i shkurtër që bën udhëtari a një mjet udhëtimi në rrugë"; ndalje f. "ndalë"; dale! "qëndro; prit"; dalë "prapë, prapa": s'u kthye dalë; dale-dale, kadale, kadale, ngadal, ngadale, mengadal "jo me të shpejtë; më zë të ulët; pak nga pak"; ndaloj; ndalim m., ndalesë f. Mendimi i G. Meyerit (f. 60) që kjo fjalë të jetë sloven. e vj. dalja, serbokr. dalj daljina "largësi", nuk ka gjetur pëlqim. Selisçevi nuk e rendit këtë ndër huazimet sllave të shqipes, e Tagliavini 202 këtë spjegim e gjen të papranueshëm. Si e kemi shtjelluar në Studii si Cerc. lingvisticæ X 4 (1959) 552v., kuptimi primar i fjalës është "mbaj", dhe shq. dale! nga kjo anë krahasohet me gjerm. halt! gr. π'αξ! : πανός "ngul". Kështu kjo fjalë e shqipes afrohet me fjalën kelte cymr. dâl dala daly "me mbajtë", korn. dalchen "a taking hold of", bret. dalc'h "pronë" derc'hel "me mbajtë", duke formuar një isoglosë të re kelte-shqiptare. Më anë tjetër fjala shqipe afrohet me trak. ΔΑΔΑΕΜΕ. Kjo pas interpretimit tonë do të thotë dhe, ndal më (mua); jo, si mendon Georgievi (Trakij-skijat ezik.) Dhe. del (zot) më.

nder m., f.; i ndershëm; nderoj "i bëj nder; nxjerr faqebardhë; përshëndet; nderim m.; ndër "nderoj"; shnderoj nderoj "i marr nderin, i shkel nderin e turpëroj; dhunoj"; shnderim nderim; shpërnderoj "shnderoj", shpërnderim m. Ndërsa Boppi (f. 498) e merr për fjalë vendi duke e afruar me ind. e vj. dar "nderoj" adaras "nder", që nga Miklosichi (Alb. Forschungen II 402) e G. Meyerit (EW 298, Alb. Studien IV 115) e këtej e spiegojnë nga lat. honōrem; khs. Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1046, Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 25, Helbig 37, Jokl IF 30,205; 36,133 shën. 1, Weigand 60, Skok Arhiv za arb. starinu II 328, Tagliavini 202 v., La Piana Intorno alla vorcale o lunga etj. 42,43, Studi ling. albanesi. Varia 76,77, Mann Language 26, 386v. Jokl mendon që lat. (h)onorare dha në shqipen një *(o)n(o)r-āniō e cila u zhvillua në *nr-onj e kjo në ndërroj, e që substantivi ndërë ose përfaqëson një *nerë ose është një formim postverbal; La Piana niset nga emri, duke përsjatur një zhvillim *onōri: *ondōri: *undēri: *ndēri: ndër që dha ndër nga lat. honorem. Vetëm Treimeri (Z. f. rom. Phil. 38,402) mendon se kemi të bëjmë me një fjalë vendi, e kjo për punë të ballit të fjalës, që nis me nd —.

Fjalë e mbarë gjuhës. Emri ndër është një nga ato të paka femërore konsonantike, siç janë djep-ja, end-ja, et-ja, gjeth-ja e huazimet latine të tipit gjind-ja, kryq-ja, pyll-ja; verbi ka qenë dikur pa zgjerim sufiksi, ndër, ashtu si emri; e nderoj është një zgjerim analogjik më -oj, relativisht i ri. Këtë gjengje të emrit e të verbit e pasqyrojnë përmendoret e vjetra të shkrimit bashkë me dialektet më arkaike. Khs. prej Buzukut (XXI 2b, XX 2b, LI Mbretërit IV 5.1) as mos padit, as mos mer nderë kujnaj . . . n'ashtë nderja

e kësaj jete (jetë) "ne praestes testimonium falsum cuicumque, neve detrahas cui . . . si agatur de honore huius mundi"; *Zot, ti që ordënose na me nderunë atënë e amënë ; ish nier̄i i madh përpara dzot, e nier̄i i ndershim* "erat vir magnus apud dominum suum et honoratus." Prej Budit (DC 101, 42, SC 293) *për ndër të madhe e për lavdi të Tinëzot; përse këjo ashtë ma e madheja ndër . . . ; tue e dashunë, e tue i shërbyem, e tue e nderunë.* Prej Bardhit Honor, Laus *Ndër*, Honestas *Nderja*, Recusare *Me mos e përzanë për ndër*, Remunerare *Me bām ndër për ndër*, (f. 222) *Të jam falë ndërsë "Gratias tibi ago"*, Honestare *Me nderunë*, Revereri *Me stimuem, e me nderunë*, Venerari *Me ndërunë, me adhëruem*, (f. 212) *Si të ndërnjësh ashtu kë me kienë ndërunë* "Ut salutabis ita resalutaberis, vel Ut honorabis, ita honoraberis", Admodum reverendus *Shumë i dershim*, Honestate *Ndërshim*. Prej Bogdanit (I 89, 11; 52, 17; 92, 27; 91, 27) *e u fal ndersë Tinëzot "e ringratiō Dio"*, *qi siisillido ndershim të hinte ndë dhët* "per dar ad'ogn' uno honorata sepoltura"; *me nderunë Atënë, e Amënë* "honorar il Padre, e la Madre", *e të nderjnë Pashkëlë* "e di celebrare la Pasqua"; po te ky autor (II 35, 11; 68, 18) edhe trajta e re *ku sod këtë ditë anshët ndërueu* "ove hoggidi viene riverita"; *Ndero tand Atë, e tande Amë* "Honora Patrem et Matrem". Burimet e mëpastajme tregojnë se gjinia femërore e emrit dhe trajta e pazgjeruar e verbit kanë qenë përdorur gjer vonë e përdoren vise-vise edhe sot, e se pra mashk. *nder-i* e verbi *nderoj* janë mjaft të reja. Khs. prej Mitkos (f. 19 Nr. 217) *Ndërëja s'blihet me para*, prej tosk. jugore (p.sh. Tepelena) *të ruat nderja* "të falem nderit", në Elbasan *t'u rritë nderja* (M. Domi), geg. veriore *nder-a*, te Kanuni i Lekës (f. 65 § 600) *Aj, të cilit i u muer ndera, xëhet i dekun kah kanëja*, verbi *ajo pak nder mbretinë e tuti kafshëvet* (te G. Meyer, Alb. Studien VI 22). Shprehja *ta di për nder* i përgjigjet p.sh. greq. *χαρῖν εἰδέναι* te Homeri; kuptimin "pres si mik, gostit" që ka *nderoj* e ka dhe serbokroatishtja (*počastiti*), si dhe rumanishtja e ukrainishtja, sh. Scheludko Balkan-Archiv II 131; në anët e Elbasanit *nder* ka dhe kuptimin "vleftë, çmim, fitim", poashtu si gr. *τιμή*, , *tregëtia e leshit s'ka nder*, dhe te Kristoforidhi (Dhiata e Re geg., Matheu 27,7). Në Greqi emri *ka* hyrë në grupin e femëroreve më *-je*, verbi edhe këtu është *nder*: në Poros *sel(I)më rrobën e prejashme, çë vesh të ndërjesë, mirë ditë ndërjesë sate*, si dolli *m'i se të vate, falemi ndërësë sate; po doni, të vini, të u nder?, të ndërhem nd'ata* "um vor ihnen guten Eindruck zu machen" (Reinhold Antologjia e litografuar 33, 34, 35, Glosari 37), sh. dhe G. Meyer Alb. Studien V 96. Në arbërishten e Italisë *ndër-a* si në geg. veriore, *te ndërë e kësaj nusse* "negli onori di cotesta sposa", *ndërë e të kërshtevët një mot* "onore dei cristiani un tempo" (de Rada Raps. alb. 63, Fiamuri Arbërit I Nr. I 1883 f. II, Kamarda II 96), në Siqeli *e ndërë i qe dhën kardināl Mait, kër te ljufta ndërë shijn* "quando l'onore spinge alla guerra", Fiamuri Arbërit II Nr. 2 f. VII, II Nr. 1 f. V (P. Chiara), *Ndër tët at e tët emë* Fjala e t'in Zoti I 26 f. 1. Mbiemri në Piana dei Greci *i ndërë*, fem. e *nderme*.

Spiegimi i emrit *nder* nga lat. *honōrem* e i verbit *nderoj* nga *honorare* është i pamundur. Pas *draconem: drangua, capreolus: kapruall* etj. *honōrem* nuk mund të jepte tjetër veçse një geg. **nuer* tosk. **ruar*; prandaj edhe *tmer* nuk është lat. *timorem*. Nuk mund të nisemi as nga *nderoj* duke e çuar këtë te lat. *honorare*, sepse *nderoj* është trajtë e re; trajta e mirëfilltë e verbit është *nder*, formim që sot paraqitet pa zgjerim sufiksial e që si i tillë hyn në një klasë verbesh denominative që është shumë e lashtë, paralatine, meqë verbet e burimit latin nuk marrin më pjesë në këtë lloj formimi, sh. Jokl Slavia XIII 299 e më parë Pedersen Roman. Jahresbericht IX I 211. Kështu burimi latin i kësaj fjale, për arsye fonetike e morfologjike, nuk mund të qëndrojë. — Ideja e nderit ka dalë shpeshherë nga kuptimi konkret i fytyrës

ose nga ai i të shikuarit. Kështu got. *wulPus*, "δόξα, madhështi", lat. *vultus* "fytyrë, çehre" e kymr. *gweled* "me pa" sipas Vendryësit (Bull. Soc. Ling. XXII 24 vv.) kanë dalë nga një rrënjë *uel- "shoh": "C'est une croyance celtique que le visage, symbole de la personne, est le siège de l'honneur. Le même mot a les deux sens en gaélique et en brittonique: irl. *enech*, gall. *wyneb* (*gwyneb*) qui signifie proprement "visage" s'emploie couramment aussi pour désigner l'honneur". Kuptimin "nder" të këtyre fjalëve të keltishtes H. Zimmer e ka lidhur me ligjën kelte që fyysi do t'i paguajë atij që ka fyer çmimin e një pete të artë në madhësinë e një fytyre, sh. dhe IJ IX II Nr. 81. Ndërsa lat. *honor* mbetet e errët, *respectus* ka dalë nga ideja e të vënit re; gr. *δόξα* "famë" lidhet me *δοκεύω* "vë re" *δοκεῖ μοι* "më duket". Nga fusha e gjuhëve romane khs. *Livide sin là dove appar vergogna* (scil. për fytyrën) te Dante (Inferno 22, 34), frgj. *effronté* it. *sfrontato* "i paturp, i pafytyrë" ("i paballë"), it. *persona di riguardo* "njeri i nderuar, i autoritetshëm"; nga gjuhët gjermanike khs. got. *gariuds* "i ndershëm" në thelb "që i skuqet faqja", gjerm. *achte* "vë re" e "respektoj" *Achtung* "vëmendje; nderim"; nga sllavet serbokr. *obraz* "faqe, fytyrë; nder" te Vuka 447 "Wange; Scham und Ehre, pudor" *obrazan* "i ndershëm" *bezobrazan* "i paturp, i pafytyrë", *ugled* "nder, prestigj" në thelb "pamje, dukje", *svetla lice* etj.; khs. dhe turq. *yüzüsu* "nder, ndershmëri; të ardhur turp, mbarre", *yüzüsz* "i paturp": *yüz* "faqe, fytyrë". Nga fusha e shqipes hyjnë këtu shprehjet formuar me *faqe*, si *me faqe të bardhë*, *me faqe të zezë*, *na zbardhi faqen*, *na nxiu faqen*, *s'kam sy e faqe*, te Budi (DC 176b) *Me qish faqe me qish sy Aty kam me u afruom*, me kompozitet *faqebardhë*, *faqezi faqezezë*, *faqelarë*, *faqekuq* "i ndershëm"; *më mori fytyrën* "më mori nderin përpara të tjerëve", *s'kam fytyrë t'i dal përpara*, *i pafytyrë*, te Reinholdi (Glosari 9) *s'kam hundë* "δέν έχω πρόσωπον, έντροπέμαι" *le të marë hundët të vijnë* "le të guxojë të vijë"; *njeri pa cipë*, *cipëplasur* "i paturp", *i ka plasur cipë*, *i ka plasur delli i ballit*, *ballëhapët* "faqelarë", khs. edhe *nuk e vrug fytyrën* "s'e nxij faqen unë", *gjyestu n'arrë!* "pastë faqen e zezë!" te Gazulli 277; e m'anë tjetër *Jeshe nisë me perdë* (te Dine 309), nga turq. *perde* që përdoret dhe me këtë kuptim të figurshëm. Në këto rrethana ka të gjare që edhe *nder* ka arritur te kuptimi i sotmë nga një më konkret, "fytyrë" ose "pamje". Gjurmët e një kuptimi të tillë duket të ruhen gjer më sot; khs. *bani nder mishit* "ki kujdes për mishin, ki mendjen te mishi" në Ndroq; *mbase edhe ndërrazi* "άντικρύ, karshi" që ka Tasi, pra "ballë për ballë". Atëhere *nder* mund të jetë refleksi i një **andár-* e të afrohet me *andër* *ëndër* nga një **andar-*, pra me shpërngulje të akcentit, ashtu si te *ambël* *ëmbël*: *mjaltë*, *ager* : *gare*, *avull* : *valë* etj. Si kuptim i parë na del aty "pamje"; kjo dhanganjë anë "ëndër" (khs. rum. *vis* "ëndër" nga lat. *visum*), nga ana tjetër "nder". Fonetikisht **andár-* mund të ketë dhënë në krye të herës **ndar*, kjo në plural *ndere*, pra te *nder* mund të kemi të bëjmë me një plural të singularizuar; **ndar* pl. *ndere* : sing. *nder*. Te *andër* *ëndër* përkundrejt gr. *ὄναρ ὄνειρος* e arm. *anurj* që i përgjigjen etimologjikisht, okluzivi dental si tingull kalimi në grupin *nr* shihet se i përket një zhvillimi të brendshëm e të mëpastajmë të shqipes. Pokjo gjë do të pranohet atëhere dhe për *ndër*, formimi i së cilës lidhet me atë të *andërë-s*.

ndërkaq "në kohën kur ngjante kjo punë". Përkundrejt popullores *aqhera* të geg. jugore e *mbiatu* "mbi atë" të arbërishtes së Italisë (sh. këtë), *ndërkaq* është fjalë librash, e cila me kohë u përgjithësua. Buzuku përdor *ndëkaqë* e *përkaqë*: *E ndëkaqë mbërititinë dishipujtë e t'i* "Et continuo v'erunt discipuli eius", it. "E in quel mentre arrivarono i suoi discepoli?"

(LIII/2, Gjoni 4, 27), Kristoforidhi geg. *Edhe mbi këto erthnë dishepujtë e t'i. Përkaqë me kuptimin "prandaj", p.sh. (XXX, Romakët 15,7; XXXI, Isaia 7,14) E përkaqë ju përzini njani tjetërinë për ndër "Propter quod suscipite invicem . . ."; E përkaqë aj Zotynë t u apë shenjhtë "propter hoc dabit Dominus ipse vobis signum". Budi ka ndaqa : SC 164 se ndaqa pa a mos ish përsëri kund përziem e palavuom me farmëkutë ndonjij mpkati murtar. Të dyja ndajfoljet janë pas gjase përkthime nga italishtja, ndërkaqë nga intanto, përkaqë nga pertanto, përkthime shkrintarësh, kryer mjaft heret. Tek e sotmja ndërkaq kemi një zëvendësim parafjalësh, ndë me ndër, ashtu si te ndërsa përkundrejt më së vjetrës ndësa; nuk ka vend të mendohet për it. *frattanto*. Nga dy ndajfoljet zuri vend vetëm ndëkaq ndërkaq; përkaqë nuk hyri në përdorim.*

ndërlëq, ndërlik "ngatërroj fijet e pëlhurës; ngatërroj" *ndërlëqem* "ngatërrohem me një". Mungon te G. Meyeri. Si e vuri re sëpari Kristoforidhi f. 271, me shënimin e tij "sh. liqet'e krahënit pëlhurësë", kjo fjalë lidhet me *liq*-të. Pokështu Weigandi 61. Khs. vrejttjet tona në Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 46. Popullore janë: *ndërlëq* f. "ndërlëkim", *ndërlëq* f. "trinë gardhi për të mbyllur vathën, lajkaq", *ndërlëq* f. "thurimë; kafas i dritares". Nga *ndërlëq* është formuar zgjerimi *ndërlëq* bashkë me *ndërlëkim* m., forma më e përdorur sot, me kuptimin "komplikoj", "komplëkim".—Ky spjegim jepet nga të dhënat e realieve, nga "fjalët dhe sendet". Për *ndërlëq* "ἐμπροσθεν", ngatërroj", që jep Reinholdi (Glosari 57) për shqipen e Greqisë, *ore ishte ndërlëksurë* "se ç'qenka ngatërruar" (për fijen), Kamarda I 42 e G. Meyeri 301 burimin egejnë në gr. *ἐντυλίσσω* "mbështjell". Fjala greke ka dhënë në gjuhën shqipe diçka tjetër, e pikërisht në tosk, jugore *tilëq*, nga aoristi *ἐντυλίξα*. *ndërlëq* nuk është veçse një trajtë e *ndërlëq*, po mundet që të ketë ndikuar disi dhe fjala greke. Sh. edhe vrejttjet e Lambertz-it (KZ 53, 305) në lidhje me *ndërlëq*, në arbërishten e Molizes *ndërlëksur*. Veçse te kjo e fundit mund të ketë ushtruar një ndikim *pleks pleksur*, edhe kjo një huazim prej greq. së re.

ndërmjetës m. Neologjizma *ndërmjetësi* f., *ndërmjetës* f., *ndërmjetësim* m. G. Meyeri 299 e spjegon drejt nga *ndërmjet*, po në një tjetër vend (f. 159) formën *indërmjës* të Rossit e nxjerr prej it. *intermezzo*. Helbigu f. 31v.) pa se *nnermiets* e Junggut, geg. e mirëfilltë *ndërmjetës*, kanë dalë prej *ndërmjet*; po sipas tij ato dhanë *indërmjës* duke u përzier me ven. *intermediario* "ndërmjetës".

I ndërmjetës nuk është veçse *ndërmjetës* me artikullin prepozitiv *i*, sh. Bul. për Shk. Shoq. 3 (1955) 40. Bie kështu dhe nevoja e një ndërhyrjeje të ven. *intermediario*. Për *ndërmjet* *ndërmjetës* sh. te *mjet*.

ndërsa "gjatë kohës që, në kohën që; (për kundërshtim) kurse". Mungon te G. Meyeri. Del që te Budi si *ndësa*, SC 245 *përsë posikundrësë plaga e korpit e ndësa ashtë njomë e rësht pā malcuom mā udob ashtë me u shëndoshunë*. Në kundërshtim me ndajfoljen *ndërkaq*, që është sajuar pas italishtes, lidhëza *ndësa ndërsa* u ka formuar me mjetet e brendshme të gjuhës, në ngërthim të fjalisë, me gjithë se mbase edhe kjo prej shkrintarëve. Gjuha popullore përdor të thjeshtën *sa* me kuptim kohor "gjatë kohës që, në kohën që, ndërsa", në fjali si *sa mendohet i urti, i marri mbaron punë*, khs. edhe Pedersen 185. Në formim të saj *ndësa* ka një analogji të shënueshme me rum. *intrucit* "ndërsa", edhe kjo fjalë për fjalë "ndërsa". E sotmja *ndërsa* ka dalë nga *ndësa* me zëvendësim të *ndë*-së me *ndër*, ashtu si te *ndëkaqë* : *ndërkaq*. Kuptimi kundërshtor (adversativ) "kurse" u ka zhvilluar nga kohori, si shpeshherë. Gjuha e re për "ndërsa" me të dyja kuptimet përdor edhe *mësa*, që është një ngjitje e parafjalës *më* me *sa*. Për *mësa* Budi (DC 167) ka *mse* : *për këto*

fjalë mse s i thuo mbë gjuhu tanë, ashtu si mun i ndëgjoish mā mirë, po j thuo për letërë.

ndërtój, dërtój "ngreh një godinë; gatit (një gjellë, një sallatë, një kafe etj.); **dërtelë dërtelë** f. "ndërtim"; **ndërtim** m., **ndërtesë** f. "godinë", neologjizma. Spiegimi që jep G. Meyeri 66 nga një lat. **directare*, prej *directus*, pranohet te shumë dijetarë: Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1049, Candrea-Densusianu 82, Jokl Revue Intern. d. Et. Balk. II 60 v., duke e vënë fjalën e shqipes në paralelizëm me arom. *derepta*. Kështu dhe Papahagi 745, i cili ndërkaq për aromunishten jep vetëm *ndreptu*. Dyshime te Rosetti Mélanges 290. M'anë tjetër Kamarda (I 12) e më vonë dhe Weigandi (f. 60) te *ndërtoj* shohin një formim verbal nga *drejt*, pra një zhvillim nga *drejtoj* në *dërtoj*.

Trajta primare e fjalës është *dërtoj*, e cila sot është rruddhur në një përdorim dialektal. E ka tosk. jugore, Bregu i Detit (M. Totoni), si dhe shqipja e Italisë, sh. Kamardën II 145. Në Labovë të Kryqit (pranë Libohovës) *nuse e dërtuar* "nuse e nisur, e stolisur" (E. Lafe). Kësaj i përgjigjet emri *dërti* f. "të kuqtë e të bardhët që vë gruaja në fytyrë" i Gjirokastrës e i Tiranës, fjalë që ndërkaq në Greqi do të thotë "vegël". Nga këto del se *n-* te *ndërtoj* është aksesore: prefiksi *n-* nga një e vjetër *en-*, o shtesë thjesht fonetike. Spiegimi nga **directare* e rindërtuar lëkundet nga puna se një e tillë bazë nuk del asgjekund në gjuhët romane, të cilat kanë vetëm reflekte të **directiare*. Prandaj për **directare* nuk ka asnjë mbështesë; dhe arom. *derepta*, në qoftë se ekziston, nuk duket të jetë veçse një formim i brendshëm nga *drejpt*. Përveç kësaj, nuk është afër menç që shqipja të ketë marrë nga latinishtja tri trajta verbale të së njëjtit grup, *dërgoj* nga *dirigere*, *ndreq* edhe *ndërtoj* nga një **directare*. Si e kemi shënuar dhe gjatë (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 1, 1958, f. 34v., Revue de Linguistique VII 1 196), *ndërtoj* nuk del gjekundi tek autorët e vjetër të Veriut; në rasat ku sot përdoret kjo, ata kanë *trajtonj*. Khs. prej Buzukut (XLIII/2, Mateu 25,34; LXIV, Mateu 26, 19) e ju *gëzoni regjëninë qi juve anshët trajtuom qysh së zanët së shekullit* "possidete paratum vobis regnum a constitutione mundi", e *trajtuonë Pashkënë* "et paraverunt Pascha", bashkë me emrin *trajt* në *Ban trajt shtëpisë sate* "Dispone domui tuae" (XLI/2, Isaia 38, 1). Ashtu edhe Bardhi ka *Aedificare Me trajtuem shtëpinë*. Prandaj *dërtoj ndërtoj* gjan të ketë dalë brenda shqipes nga *trajtoj* nëpër një **tërtoj*, me reduktim të *a-*së së patakse në *-ë*.

ndërrój ndroj "këmbej; ndryshoj; *ndërrohem ndrohem* "vesh ndërresa të lara, a rrobet e mira"; *ndërrim ndrim* m.; *ndërresa ndresa* fpl. "këmishë, brekë, çorape e fanelë së bashku"; *ndryshe*. G. Meyeri më vonë (f. 300, Alb. Studien IV 15) e nxjerr nga një lat. **anterare*, variante disimilimi e *alterare*, e *ndryshe* si të thuash nga një **alterusius*. Mendim i pranuar te Philippide II 665 e te Tagliavini 203. Më parë Kamarda (I 45, 73) e kish afruar me *jetër* "tjetër" e me gr. ἔτερος "tjetër", duke e spieguar prej një baze **év-έτερο-ώ*. Weigandi 61 e barazon me *nderoj* (!).

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku (XVII, Psalm. 37, 17; LXXXVIII = =LXXXVIII, Mateu 17,2) e për *sā herë u ndërroj këmbët e mī* "et dum commoventur pedes mei", *E aty ndërroi fëtyrënë përpara faqesë tyne* "Et transfiguratus est ante eos"; khs. edhe (XII/2) *tre ndërime e njëj vete*. Bardhi Mutare *Me ndëruem*, Summutare *Me ndëruem*; Bogdani (I 1, 4; 35,12;80,7) *përse ndërrohem i për herë* "perche mi cangio ad ogn' hora"; e *ndjerë tash kurraj pa mbetunë as pa mos u fëtigunë, as pa mos u ndëruem* "senza mai cessare, ne stancarsi, e senza entrar altri in questo suo ufficio"; i *ndërroi Zotynë*

emënitë Jakobit, e i vu Israelë "mutò Dio il suo nome di Giacob in Israele". Për përdorimet e sotme khs. sidomos Pedersen 166, Fjal. i gju. shqipe. Për kuptimin e emrit *ndërresa* ndresa khs. rum. *schimburi* "ndërresa" nga *schimb* "ndërroj" e *izmene* "brekë" nga sllav. *izmena* "ndërrim, këmbim"; gr. e re *ἀλλογῆ* "rrobë"; it. *mutande* (te G. Meyer, Alb. Studien IV 30; Puscariu EW 1548). — Një lat. **anterare* nuk dëshmohet gjëkund dhe sigurisht nuk ka ekzistuar; edhe *alterare* nuk rron në gjuhët romane veçse si fjalë librash (frgj. *altérer*), sh. Meyer-Lübke REW 383; khs. dhe vrejtjet tona në Rev. de Linguistique VII 1 191. Kemi të bëjmë me një fjalë të fondit autokton, e afër me ind. e vj. *ántara-*, got. *anPar*, lit. *aútras* *aútaras* etj., sikundër e pat parë mirë G. Meyeri më parë. Në shqipen ndërkaq primitivi nuk rron, po ruhet vetëm te *ndër-øj*, refleksi i një **antar-* + *-øj*; kjo, duke pasur theksin në mbaresë, pësoi aferezën e vokalit. Shq. *ndërroj* si një verb denominativ i kësaj rrënje i përgjigjet gjerm. *ändern* "këmbëj, ndërroj"; *anderer* "tjetër" e lit. *ántrinti* "me përsëritë". Te *endëronj*, fonetikisht *ndëronj*, e Buzukut, ruhet në nazalin sonant gjurma e vokalit nistor të dikurshëm. Te trajta *ndërroj r-*ja e fortë mund të ketë rrjedhur nga një geminacion ekspresiv.

ndëshkōj "dënoj një njeri, i jap një dënim të lehtë; *ndëshkōim* m., *ndëshkōimōr* -e (neologjizma). Ka mbetur pa spjegim te G. Meyeri 68 (*dishkōj, ndëshkōj, ndëshkōj* "ermahne, tadle, rate").

E ka vetëm gegërishtja, e aty kryesisht ana veriore. Buzuku (XLVIII/2, Gjenez 37,10; LVII, Isaia 1,18; LXVIII=LXXVIII, Gjoni 16, 8) e *ndishkōi* i ati "increpavit eum pater suus"; *Eni m̄basandaj e më ndishkōni* "Et venit, et arguit me"; *të ndishkōnjë shekullinë η kateshit e η sē p̄līgjeshit e η gjygit* "arguet mundum de peccato, et de iustitia, et de iudicio". Budi (DC 185b, 187b, RR 12, 51, 197; SC 3,117, 263) *Disa fjalëzë për hie Jetënë me ua ndishkuom; E i foli me ndishkō; fortue i mpsuom, e tue i ndishkuom qi... të jënë,... mkateshit...shtëmangunë e larguom; fort tue e qortuom e tue e ndishkuom pr agë të madh të verbënë; me ua qitunë poshtë, ende me u bām sã të tjera ndishkō, e dhūnë; qi të mos jëtë i zoti me e qertuom e me e ndishkuom; disa me të mirë e me të lutunë, disa me qartë e me ndishkō; gjithëherë duhetë me j qertuom e më j ndishkuom.* Bardhi Monere *Me ndishkuem, Monitum Të dishkuem, Obiurgare riprendere, Redarguere Me ndishkuem, Obiurgator riprensore, Reprehensor, Saasor Ndishkues, Praemonere Me e ndishkuem përpara, Reprehendere Me e qirtuom, o me e dishkuem, Reprehensio Të dishkuemitë, Suadere persuadere Me dishkuem* (te ky autor grafitë me *d-* janë fonologjikisht irrelevante, ato dëshmojnë shqiptimin e dobët të *n-së* në neksin *nd-*). Bogdani (I 112, 8; 6, 26, II 90, 21) *kūr Zotynë i ndëshkōj për mkate tijnaj Popullinë* "quando Dio castigò per il peccato commesso il Popolo"; *Ndëshkon Jesu Krishi* "Amonisce Giesù Christo"; *m u goditë mue ndëshkōimi* "venga sopra di me il castigo." Vendimet e Kuvendit t'Arbënit të *ndishkohet me fjalë tande* (Rrota HD VIII 349). Në literaturën e vjetër mbizotërojnë kështu kuptimet "qërtoj" e "kshilloj", sot përdoret për një dënim më fort të lehtë. Si e kemi shënuar shkurt dhe në Revue de Linguistique VII 1 177, burimi i fjalës është lat. *castigo*, -are, e cila rron dhe në gjuhët romane, sh. Meyer-Lübke REW 1746. Shqipja e ka ruajtur kuptimin e fjalës latine, ashtu si disa nga ato gjuhë, kurse rumanishtja ja ka ndryshuar fare, sh. Puscariu EW 377, T. Papahagi 293. Fjala latine ka shkuar dhe në gjermanishten, si *kasteien* gjerm. e lartë e vj. *chestigōn* dhe e mesme *kastigen*, Kluge-Goetze 289. Në shqipem *castigare* duhej të kish dhënë **këshgoj; ndëshkōj* i detyrohet ndonjë etimologjie popullore, sidomos ndikimit të verbeve me preverb *ndë-*, duke u marrë fjala gati si *ndë-shkōj*; nga *ndëshkōj* e *ndishkōj* forma me -ë- është primarja, ajo

me -i- rrjedh nga ndrimi -ë:i në silabë paratheksore. Ndërkaq nga trajta e mirëfilltë e fjalës një gjurmë duket se ruhet te *kështuer* **castigatorium* **castigatore*), sh. këtë fjalë. Sikundër e shtjellojmë dhe në vendin e cituar, prej Italisë fjala ka hyrë dhe një herë në shqipen, si it. *castigare* që dha *kastigoj*, sh. këtë fjalë.

ndiç pra". Mungon te G. Meyeri. Bashkimi ka *nniç* "e però, come sto a dire", Gazulli për Shkodër *ndiç* = lat. ergo, gjerm. also, it. dunqe, adunque. "Lidhëz përmyllëse (konkluzive) te Kurti I² 93: *Ndiç: K ù asht bashkimi asht forca, e kù asht dasija asht shkatrrimi*. Është një nga ato pjesëza e lidhëza që kanë dalë prej një fjalie a gjithësi në ngërthim të fjalisë (në sandhi), si *as, dot, ndorrina, pondë pon, sos, shkllata. ndiç* ka dalë nga *në diç (ti)*, khs. edhe *ndiç ti, e në do të dish* për "pra, në të vërtetë". Nga *në dish* (me -sh) ka dalë *ndish* e Budit (SC 152) : *e kush na mpson s pat, ndish në ato fjalë pak kanë me na ndimuum*. Në shqipen e Greqisë thonë *inish-inish* "kështu e kështu, si qeshë tue thanë, që thua ti". Këtë G. Meyeri (Alb. Studien V 80) e afron me *nish-nish, inish-inish* "aty për aty, përnjëherë", për të cilën ai më parë (EW 310) kish menduar si burim — po me dyshime — gr. e *ῥῖσος ῥῖσος* "i barabartë, i drejtë". Ka të gjarë që edhe ajo fjalë ta ketë burimin këtu. Sh. edhe *enashi*.

ndiej "kam një ndjenjë" e "dëgjoj, gjegjem", *ndihem* "dëgjohe" (nuk *ndihet* fare); *i ndier, i ndjerë* "i dëgjuar, i famshëm". G. Meyeri më parë (Gram. 94) e bashkonte me sinonimin *gjegjem*, po më vonë (EW 66) e lidh me *di*. Kamarda (I 81) e afronte me gr. *νοέω* "vë re; matem, synoj". Bashkimin me *gjegjem* si dhe atë me *dëgjoj* e hedh poshtë Pedersen (KZ 33, 547), po atë me *gjegjem* e përsërit Bariçi I 33v. Tagliavini 203 i mbahet mendimit të dytë të G. Meyerit.)

Fjalë e mbarë gjuhës. Budi (DC 187a, 211a) *Ti me ndiem të xbuluom, Ndo turp e mbarre veti; Qi shekulli gjithë ndjeu Për së gjanë e për së gjatë*. Bogdani (I 98,7) *Regji tue ndiem një zemërë kaqa të madhe nd atë djalë* "Il Re sentendo un si gran animo nel giovine". Grigori (f. 34, Mateu 11,2; 76, Mateu 22,45) *E Joani, si ndjeu ndë hapsanë punërat e Krishtit; E si ndienë të parët e priftëret, edhe farisejtë parabolit e tij*". Shprehja (me aliteracion) *ndier* e *i dëgjuar* e Gjirokastrës del dhe te N. Frashëri (Ist. e Skënd. 95) si *të dëgjuar e të ndjerë*, si dhe në Rekë të Dibrës, *i ndiet* "i përmendun" (Bageri, Shkolla shqiptare V 44). Në gjuhë të shkrimit sot mbizotëron trajta e dialekteve që thonë *ndjej*, nga e cila është formuar dhe neologjizmi *ndjenjë* f.; kurse *ndies* f. e *ndieshëm* janë sajuar prej *ndiej*. Populllore e dialektore është *ndiej* "dëgjoj, gjegjem" në Çamëri edhe gjekë, sh. dhe Pedersen 105; Shpati ka edhe *ndij një andër* "shoh një ëndër". Në Greqi si më mirë *ndienj vétéhenë* (Reinhold Antol. e litografuar 40, ishulli Poros), në Atikë *Ajo nëkë ndiejti*. *Do ish ndë gjumë të parë e u ndienë meta fjalëtë që thoj vajza* (Furikis, *Ἀθηνά* 45, 106). Në Kalabri (Santori) *kur u mëngu të ndienj se atti gjëndë?* (K. Kamsi, Leka XV 109), në Siqeli (Fjala e t'in Zoti I 22 f. 3) *por t'jini të ndërtuam (të gjithë) mbi një ment e mbi një të ndieme*. Forma bazë e fjalës nga këto të dhëna shihet se është *ndienj*, prandaj përjashtohet çdo lidhje qoftë me *di* qoftë me *gjegjem*; kuptimisht ndërkaq fjala paraqitet sot si një sinonim i *dëgjoj* e *gjegjem*. Etimologjikisht *ndiej*, si refleks i një **n-tienj*, e kjo i një bazë parashqiptare afërsisht **en-tegnio*, pas gjithë gjasësh afrohet me grupin lat. *tongeo tongere* "nosse, scire" *tongitio* "notio", osk *tanginom* "sententiam"; got. *Pagkjan* "βουλεύεσθαι, λογίζεσθαι" gjerm. *denken* "me mendue" etj., për të cilin khs. Walde-Pokorny I 744, Ernout-Meillet 1045, Walde-Hofmann II 690, Pokorny I 1088. Një vërtetim të kësaj etimologjie ne e gjejmë dhe në këtë, që, sikurse në gotishten verbit *Pagkjan* i përgjigjet tjetri verb

Pugkjan "δοκεῖν, φαίνεσθαι", gjerm. *dünken* "me u dukë", ashtu edhe në shqipen me ndihet, pasivi i *ndiej*, do të thotë "më duket", sh. *ndihet*. Në këtë mënyrë fjala e shqipes përbrenda grupit në fjalë afrohet më fort me gjuhët gjermanike se me italiket. Për fjalët gjermanike khs. Kluge-Goetze 100 v. 118.

ndih ndif, *ndihmë ndimë ndifmë f.*, *ndihmój ndimój ndifmój*, *ndihmës m.* (edhe si element i parë në kompozite, *ndihmës-mjek*), *ndihmëtar ndihmëqar*. G. Meyeri 300 e shpie -me rezervë- te një bazë shqiptare **ndenh* e parashqiptare **tenk*, duke e krahasuar me got. *Peihan* "me shkue mbarë, me trevë" saks. e vj. *thengiu* "kryej, mbaroj" lit. *tenkū* "mjaftohem me diçka" irl. e vj. *tocad* "lumtëri, mbarësi", po vetë ai çfaq dyshime më vonë, në Alb. Studien III 6v. Spiegimi i tij nuk ka hyrë në fjalorët etimologjikë. Weigandi 60 kufizohet me shënimin lakonik "indoeuropiane". Scheftolowitzi (KZ 56, 208v.) *n-dih* e merr si refleks të një baze **dhiskō* dhe e afron me av. *dāy* "përkujdesem".

Fjalë e gjuhës mbarë. Autorët e vjetër të Veriut e kanë pa -h: Buzuku (XVI, Psalm 6,4; XIX, Psalm 69,2; LVII, Isaia 1,17) *Ma ti, Zot, djerie kur të më apsh ndimë?* "sed tu Domine usque quo?"; *O Zot, këqyrë ndë ndimë teme; O Zot, solicitou ti muo me klenë ndimëtar* "Deus in adiutorium meum intende: Domine ad adiuvandum me festina"; *ndimoni atī qi anshhtë ndë nevojë* "subvenite oppresso". Budi (DC 42, 21, sh. dhe 178b, 207b, SC Parathënia 3a) *e të na dërgonjë mā çpejt ndimënë e Regjënīsē vet; ndë një ças gjindetë gātī me të ndimuom*. Bardhi *Adiuvare Me ndimuen* (sic! gabim shtypi?), *Adiutor Ndimëtar*, *Auxilium Të ndimuem*, *Iuvare Me vëjyem, me ndimuem*, *Succurrere Me ndimuem, me votë mbë ndimë*.

Etimologjia e G. Meyerit, të cilën e vë në dyshim vetë autori i saj, nuk përlligjet as fonetikiisht as kuptimisht. Gjuhët indoeuropiane nuk kanë -e as mund të kenë — një fjalë gjer diku të përbashkët për konceptin e *ndihmës*. Në ato, si dhe në të tjera gjuhë, ky koncept ka dalë prej burimesh së ndryshme. Një nga këto është ideja e të dalit, të çfaqurit, të ardhurit në *ndihmë*; khs. prej shqipes vetë *buftoj* "dëftoj", te Variboba *buftonem*. Atëhere *ndih* gjan të jetë në thelb "dukem, çfaqem" e t'i përkasë rrënjës indoeuropiane **deik* — **dik* "tregoj"; ind. e vj. *disāti* "tregon, shënon", gr. *δείκνυμι* "tregoj", lat. *in-dico*, -are "tregoj", gjerm. *zeigen* etj. Në këtë drejtim dëshmon edhe ndërtimi i *ndimoj* me dativ te Buzuku, e pokështu i *ndih* edhe sot, gjë që shpie te "i dal në *ndihmë*, i çfaqem" si kuptim i parë i fjalës. Në qoftë se -h te *ndih* është e vjetër, si bazë për *ndih* do të mendohet një **en-dik-skō*. Emri *ndihmë ndimë* është një postverbal më -më. Prej atëj u formua verbi *ndihmoj ndimoj*. — Kjo fjalë e shqipes mund të *ndihmojë* për sqarimin e burimit të lat. *Di Indigetēs* që merret përgjithësisht si "Hyjni vendi, hyjni nationale" e që ka mbetur e pasqaruar për nga ana e burimit etimologjik, sh. Ernout-Meillet I 484v., Walde-Hofmann I 693. *indiges*, pl. *indigetēs* duket të jetë "ndihmës, ndihmëtar": duke u lidhur me *index indicare* e mbase edhe me *digitus* "gisht", gjan të përmbajë një kuptim të vjetër që ruhet dhe në *ndih* e *ndihmë-n* e shqipes.

ndihet (më), *më ndjetë* "më duket", aoristi *më ndot*, *më ndy*. G. Meyeri nuk e ka te Fjal. etimologjik. E jep më vonë (Alb. Studien V 97) për shqipen e Greqisë, me dy trajta: *më ndjetë*, në Poros *më ndihetë*, e pas Reinholdit (f. 92) *më ndotë*; të parën e bashkon me *ndiej ndjej* e kështu e afron me *di*; për të dytën mendon — me rezervë — për një lidhje me *ndodh ndodhet*.

Fjalë e gjithmbarshme, që ruhet si tek autorët e vjetër, si nëpër dialektet e sotme, si në kolonitë e Greqisë e t'Italisë; ndërkaq në shqipen e re ka bjerrë mjaft nga përdorimi i saj, mbase nga puna e honimisë që përbën me *ndy*

e me format e saj, si *më ndyhet*, *m'u ndy*, *m'u ndot*, *i ndjetë*. Del që te Buzuku (XLVIII/2 Gjenezë 37, 7 e 9); *Me ndihë se na nlidhnjim duoj ndë vjedmis arësë* "Putabam nos ligare manipulos in agro, Mi pareva che noi legassimo i covoni nel campo"; *Më ndihë se dielli e ana e njëmbëdhjetë uij muo nfallish-në* "Vidi per somnium, quasi solem, et lunam, et stellas undecim adorare me". Budi (DC 168 e 169, SC 10, 103,³³) *präshtu muo më ndjetë se ajo uratë... më parë munë quhetë të qëllunë dhünë Tenëzotnë; aj s më ndjetë se e mbush mirë e me arrësye oficienë e vepërënë e vet; o kūr i ndjetë keq. A mos të kish ndym keq disaherë*. Bardhi (Parathënia fol. 3,5; 4, 4) *i cilli si e pā i ndy fort mirë se e keshë nkëthym n giuhet cë lëtime mbë t arbëneshët; më mbë tjetërët anë kujtova, e më (n)dy më mirë me nkëthym gjākafshë se asgjā; më ndjetë se ndër terretit e pakë dritë vëjen e kushton shumë*. Bogdani (Të Primitë 3, I 28, 41; 86, 3) *Ma as mbarre nukë më ndjetë, se ndjek të dītëshmītë. Dishepujet fort u ndyjtë keq tue ndiem se u tha atë fjalë të shemtueme për Mjeshtërr e tyne* "Li discepoli hebbero molto a male in sentire a dirsi simil cosa del loro Maestro"; *Fort i ndy keq* "Hebbe gran compassione" e "le era di grandissima afflizione". Nga fjalorët e rinj Cordignano ka *mos u ndyftë!* "mos e paktë syri i keq!", që e ka dhe Mirdita. Gazulli jep për Malsi të Madhe *më ndjet* "më duket", *s'më ndjet* "s'më duket", *s'më nditte* "s'm'u dukte", "es dünk mir, mi pare", *më ndjet se ka shkue, më nditte se shkova*, edhe *ndyskeq* "që i ndihet, i duket keq", poai HD XVII 549. Për shqipen e Greqisë Reinholdi (Antologjia e Itografuar 31, 91, 96) jep *më ndiëtë, do u ndiëtë atire, më ndihetë, më ndiëhetë* "μοῦ φαίνεται", *mos të ndotë çë i mari kumbora ka?* G. Meyeri (Alb. Studien V 29) *më ndiëtë se deti dëshëron të hajëkormë (hurma), Furikis (Ἀθηνᾶ 45, 102. 134. 136) për Atikë Ai e gjeq edhe i kakondinj Aύτός τ'ἀκούσε καί τοῦ κακοφάνηκε* (khs. *iu kakodük në Gjirokastër*), edhe *i ndi tham'e madhe, i dij thamë* "iu duk çudi". Për Itali khs. prej Santorit (Emira Skena V) *Mua u ndot një drankoljë* "mua m'u duk një gjarpër", prej de Radës (Raps. alb. 67) *Trimët më i nditi turp* "Al garzone parve disdoro." Mbase prej këtij verbi ka dalë edhe emri *ndjetë* f. "shkak, arsye" po te de Rada: *çë që ndietta e gjith të këqevet* "che fu già causa di tutti i mali di lei", *fanesset thitël ndietta e shkretës sän* "appare nettamente la causa dé nostri infortuni", *për ndiët liqes* "a difesa della giustizia" (Fjam. Arbërit I Nr. 1 f. II, II Nr. 1 f. II, Antol. alb. 67). Ndërkaq kjo fjalë, e cila s'na ka dalë gjëkund në kolonitë arbëreshe, mund të jetë një sajim i poetit.

Edhe nga forma shihet se *më ndihet* nuk është gjë tjetër veçse impersonali i *ndihem*, i medialit të *ndiej*, ashtu siç është *më duket* impersonali i *dukem*. Si te *më duket*, *më bëhet*, te gr. *δοκεῖ μοι*, gjerm. *es scheint mir* etj., kuptimi është aktiv, *më ndihet* "rrok me shqisë", "mendoj". Në këtë vështrim *më ndihet* si kuptimisht si etimologjikisht i përgjigjet gjerm. *es dünkt mich (mir)* "më duket, më bëhet". Dhe sikundër që kjo përbrenda gjermanishtes lidhet me *denken* "me mendue", ashtu edhe *më ndihet* përbrenda shqipes shkon me *ndiej*, e cila afrohet me gjerm. *denken* (sh. *ndiej*). Prandaj afrimi i *ndiej* e i *më ndihet* me gjerm. *denken dünken* mund të themi se është i veçantë. Është më i ngushtë se ai i fjalëve gjermanike e i shqipes me fjalët italiane, lat. *tongeo tongere* "nosse, scire" *tongitio* "notio" osk. *tanginom* "sententiam". Për fjalët gjermanike sh. Kluge-Goetze 100 v., 118.

ndodh "gjindem aty gand, rastësisht"; impers. "ngjan, qëllon, godit"; *ndodhem* "gjindem aty gand"; *i ndodhem* "i gjindem tjetrit në një nevojë"; *i ndodhur* "i gjindshëm"; *ndodhë* f. "ngjarje" (neologjizëm). Pas G. Meyerit (f. 301, Alb. Studien III 24, 83) ose e afër me gr. *τεταγών* "që rrok, që kap" e me lat. *tango* "prek", *ndodh* nga një bazë **toth-* prej indoeur.

**ūg-* me *g-* palatale; ose e afër me got. *tēkan* "me prekë" ndodh prej **dodh-*. Vihet në dyshim te Pedersen (KZ 36, 335), te Boisacq 961 e te Walde-Pokorny (I 703, 786), nuk jepet as te Pokorny I 1055, po pranohet, me një farë rezerve, te Hofmanni (Walde-Hofmann II 647, GEW 361). Bariçi I 57v. e afron me ind. e vj. *sad-* "bie", arm. *çacnum* "bie", lat. *cado* etj., Ostiri (Anthropos VIII 145 vv.) me ind. e vj. *je-hi-tē* "ikën". Sh. dhe Kamardën I 75.

Fjalë e gjuhës mbarë. Te Budi DC 2,26, SC 38) *qish ndodhi këha ndë një ças; jashtë qytetnë, ò vendnë ke të ndodhi*; Bogdani (II 101, 9) *kish dashunë ajo gjind e paudhë qi t'ishinë ndodhunë me tan' ende SS. Apostujë* "Haveria voluto quella perversa gente che fosser trovati seco anche li Santi Apostoli", sh. dhe I 84, 9; 86, 9; 117, 2; 131, 5. Në Poros të Greqisë (Reinhold, Antologji e litografuar 33,43) *m'u ndodh një çickë punë; i bardhë u leshë, i zi u ndodhshë*; Në Salaminë *Na! këtu u ndodhshë* "Νά! ἐδώ βροθῆνα (Furikis, Ἀθηνᾶ 45,62). Te Z. Skiròi (Ca. trad. 70) e *teku ndodhe* "e dove mai ti trovi". — Kjo fjalë përbën një nga konkordancat parciales të shqipes me greqishten: *ndodh*, nga një bazë **en-todh* **n-todh*, është e afër me *τεύχω* "ndërtoj, gatit, përftoj; shkaktoj" *τυγχάνω* "godit, qëlloj, has; ndodh, ndodhem". Kuptimi i hershëm i fjalës shqipe duhet pra të ketë qenë konkret: "qëlloj, godit". Edhe qëllon e *godit* përdoren për "ndodh, takon, rastis, ngjan"; khs. dhe gjerm., *es trifft sich* "ndodh": *treffe* "godit, qëlloj"; *takoj*". Baza **todh* te *n-dodh* reflekton me *o-në* e saj një bazë diftongore të gjatë **teugh-* në të cilën *ēu* dha rregullisht *o* e *gh* dha *dh*. Kjo bazë **teugh-* afrohet më fort me gr. *τεύχω* e me *τεύξομαι* (futuri i *τυγχάνω*), duke qëndruar ndaj këtyre në raport të një apofonie kuantitative (*ēu* : *eu*). Fjalën greke e afrojnë më një anë me fjalën gjermanike got. *daug* gjerm. *taugt* "hyn në punë, vlen, është me dobi" *tüchtig* "i zoti" e keltishten irl. *dūal* "i përshtatshëm" "dūan" "vjershë", më anë tjetër me lit. *daug* "shumë" rus. *duzij* "i fortë, i fuqishëm" etj., duke i përfshirë të gjitha te një bazë indoeur. *dheugh-*, me gatural velar; sh. Boisacq 963, 989, Walde-Pokorny I 847, Kluge—Goetze 614 633, Pokorny I 271, Hofmann GEW 362v., 377, Vasmer REW I 379, Fraenkel 84. Shq. *ndodh ndodhem* afrohet në kuptim me gr. *τυγχάνω* më fort se fjalët e të tjerave gjuhë indoeuropiane, ndërsa më anë tjetër me gjerm. *es taugt, tauglich* "i vlefshëm" e *tüchtig* afrohet i *ndodhem* "i gjindem tjetrit në një nevojë" i *ndodhur* "i gjindshëm". Në këtë mënyrë përfordhet mendimi që baza indoeuropiane ka mbaruar me gatural palatal, i cili dha në shqipen *dh*. Atëhere bëhet fort e dyshimtë që në këtë grup të hyjnë dhe fjalët baltike e sllave, të cilat paravendojnë një velar. I padrejtë edhe mendimi i Georgievit (që gr. *τυγχάνω*, si fjalë "paragreke", të lidhet me bullg. *na-tykvam* se "takohe, ndeshem").

ndormë (i), fem. e *ndorme* "gatuar pa brumë, pa tharm, i pambrumë, e pambrumë": *kulaç i ndormë, bukë e ndorme*. Mungon te G. Meyeri. Cimochowski (Li. Posn. II 321) e afron me gr. *τεράμων τερον* "injomë", ind. e vj. *tárunah* "i ri, i njomë", duke menduar për shqipen një zhvillim nga *(*e*)*n-tērm* në **n-tor-m* e në *ndormë*.)

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Bashkimi *bukë e ndorme*, dhe e substantivuar *norme* f. (*nn=nd*) "pane azimo o non lievitato". Ed. e Re (Ser. III, viti VII=I, Nr. 1, 1930, f. 70) jep për Lumë *enorme* "bukë me farë, e paardhur", për Dibër *bukënore* (sh. dhe Folklorë I 15); edhe pas së tjerësh në Lumë *bukë e norme* (ose shkurt *norme*) "bukë e mbrumë", te Ali Ulqinaku për Ulqin *bukndorë*. Edhe në Toskëri, dhe në të folët e katundit Villa Badessa në Abrucet: *ndormëtë* "e pabrume (Lambertz KZ 53, 305). Në Progonat të Labërisë *buk të norme*. Buzuku (LVIII=LXVIIIa) e quan *bukë fogace*,

Kristoforidhi (Deuteronomi toskërisht 16, 3) *bukë të pambrume*, P. Skiròi prej Sigtelie (Fjala e t'in Zoti III Nr. 3, f. 3) *bukë të gjeshme pā brūm të ngridhur*. Nga këto të dhëna shihet se kemi të bëjmë me një fjalë të mbarë gjuhës, e cila shënon ku kulaçin, ku bukën e pambrujtur, ku bukën e ngjeshur të mbrujtur, po pa brumë të thartë. Në ekonominë shtëpiake shqiptare buka e pambrume është ajo më e lehta për të gatuar, dhe në shumë vise më e zakonshme, që i vjen më ndoresh amvises. Prandaj fjala është një me *i ndormë*, *i ndormtë* "i rëndomtë, i zakonshëm", dhe të dyja janë rrjedhoja të *dorës*; kështu edhe *bukëndore bukënore* do kuptuar si *bukë n dore*, ku *ndore* është në thelb një me *ndorë* f. "mbrojtje", veçse aty si mbiemër, këtu si emër. Këtë etimologji e vërteton nga një anë tjetër dhe *mbasdore* "kulaç i ndormë" në Kosovë, që është *mbas dore*. Te *i ndormë* kemi leksikalizimin e një emri me parafjalë, i cili dha një mbiemër. Formën *i ndormë* për "i rëndomtë, i zakonshëm" e ka Godini te gjerman. *gewöhnlich*, kurse për *abgedroschen* ka *i ndormtë*, e Tase (te *xhevulá*) jep *njerës të ndormë* për "vegjëli". Ky jep edhe (f. 14) ndajfoljen *ndormazi* "zakonisht". Fjala *dorë* edhe me të tjera forma ka dhënë kuptimin e lehtësisë, të volisë, të së zakonshmes; khs. te Leake 312 *i dorshim* "ἐπιτηδιος, diligent, able, clever", bashkë me *më vjen dore* "ἐπιτηδεύομαι, I am ready, dexterous", te Qafëzezi e Manni *i ndorshëm* "convenient; wieldy, manageable"; te Gazulli *dor-i* m. "koha e përshtatshme": "në t'ardhtë dori, folë këte fjalë; kur të më vijë dori kam me shkue; poaty edhe kál doracak "i vogël e i shpejtë", më e përgjithshme *doracak* "i dorës, që përdoret me lehtësi"; khs. edhe *përdor*, *përdorak* e *i përdorshëm* "që përdoret kollaj". Edhe në të tjera gjuhë fjalët që shënojnë dorën kanë zhvilluar të tilla kuptime: gr. *εὐχερός* "i lehtë në të përdorur, i lehtë", *δυσχερός* "i vështirë në të përdorur, i vështirë" e *πρόχειρος* "që vjen ndoresh, i përdorshëm" (*χείρ* "dorë"), *εὐμαρής* "i përdorshëm" (*μάρι* "dorë"), sh. dhe Fraenkel Li. Posn. IV 95; lat. *manualis manualis* "i përdorshëm" (*manus*); gjerm. *handlich* "i përdorshëm, që vjen ndoresh" (*Hand*), angl. *handy* "doracak, i aftë, i përshtatshëm" (*hand*), serbokr. *naručaj* "që vjen ndoresh, i lehtë" (*ruka* dorë"), të gjitha të krahasueshme me shq. *doracak doracak*, i përdorshëm *përdorak* e *i ndormë*, *i ndormtë*.

ndorrina "ndonëse". Fjalë e arbërishtes së Kalabrisë, p.sh. te Kamarda II 114, 139: *Ndorrina se jë plak*. E paspiegaur te G. Meyeri 301. Është një juktapozicion, një fjalë që u ka formuar në sandhi si leksikalizim i një fjalisë, nga fjalisia koncesive *ndo rri* "ndonëse rri", me shtesë të një silabe *-na* si te *una* "unë", *andejna*, *asajna*, *pastajna*. Për këtë *-na* khs. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 69v. Kuptimi i parë është "me gjithë se qëndron puna që...". Khs. për zhvillimin kuptimor span. *a pesar de* "me gjithë se", fjalë për fjalë "edhe në qoftë se mëshon, se rëndon". Për fjalët e dala prej një fjalisie a një gjymtyre të saj khs. *druese*, *mbase*, *ndig*, *ndonëse*, *pondë*, *shkluta*, *thomse*. Në formën e saj *ndorrina* afrohet sidomos me *ndonëse*. Forma me pjesë të ndara dhe e pazgjeruar me *-na* ruhet te *Mbaskëndaj, no ri no jak* "Mb. ndo rri ndo eja" (Hahni, te Kamarda II 46), po këtu me kuptimin "ja-ja, o-o", sh. *ndo*.

ndoshita "mbase". Këtë fjalë të gegërishtes, që s'e ka G. Meyeri, ndonëse del që te Bardhi, Weigandi (Balkan-Archiv I 260) e jep pas Fishtës (Lahuta e Malcis II, Besa e lidhme, varg 201) si *nnoshte* (Edhe i len *nnoshte me kjā*) dhe e spiegon si të dalë prej frazës *në do të ishte*. F. Konitza (Dielli i 14.I.1938, Java II Nr. 47, 25.4.1938, f. 8), duke u nisur nga kjo që fjalët e këtij kuptimi kanë dalë shpesh prej verbesh "ndodh, takon" (gr. *τυχόν*, frgj. e vj. *d'aventure*, angl. *perhaps: to happen*), sheh këtu një *ndothita*, ndajfolje formuar nga *ndodh* me *-ta*, ashtu si *fshehta* nga *fsheh*; te Forsan *Ndosta* e Bar-

dhit ka pas mendimit të tij një gabim shtypi; në grafinë e tij *ndoŝta* disa lexuan një *sh*, disa një *f*, prandaj doli dhe *ndofta* e toskërishtes së sotme. Shp. Bardhi (Përpkjeka shqiptare 2,1938, f. 271vv.) vë në pah ekzistencën e fjalës në gjuhën popullore, gegërisht gjer në Krujë *ndoshta*, Mirdita *me ndoshta*, në një pjesë të madhe të Toskërisë *ndofta*.

Bardhi ka Forsan *Kürtë*, *Ndoshta*. Bogdani (I 3,11; 4, 16; II 101, 20) e thërrisinë *Belzebub ndoshta përse ndër të parët Idhullë kje adhëruem i pari Djall kryet e Ferrit* "lo chiamava Belzebu; forse, perche nel primo Idolo fu adorato il primo Demonio Principe dell' Inferno", *Ndoshta tue cuem sytë prej Qiellshit* "Ne forte elatis oculis ad Coelum"; *As je ti ndoshta ma j pari i ushtërisë Israelit?* "non sei tu forse, il più principale dell' Esercito d'Israel?" (sh. dhe I 8,9; II 137, 23). Me këtë dëshmi vërtetohet se fjala është *ndoshta* dhe se nuk ka gabim shtypi te Bardhi. Në këtë drejtim dëshmojnë edhe trajtat e sotme të gegërishtes: më shumë *ndoshta* (shqiptuar *ndoshta noshta*), në Mirditë *me ndoshta*, *me ndoshmi* (Donisa, Cirka II 191), te Kurti (I² 258) *ndoshti*, në Gjakovë *ndoshtu nashta* "možda" (Kujunxhiç 33, 136). Trajta *ndofta* (S. Frashëri *dofa*), e cila s'ka ekzistuar më parë, ka dalë pa dyshim — si e vuri re F. Konitz — nga një lexim i gabuar i grafisë *ndofŝta* të Bardhit, duke marrë *ŝ-në* (trajtë e lidhur egermës *s*) për *f*. Poashtu në frengjishten emri *Mouffetard* ka dalë nga *Moussetar* (Dauzat, La Géographie linguistique 1922, f. 65), në magjarishten fjala *söveg* "lloj kësule e gjatë a tanuz", shkruar dikur *Söveg*, u muar për *föveg*, duke u mbështetur te *fö fej* "krye", dhe përdoret sot me këtë trajtë (kumtim i Prof. L. Tamasit). Sa për burimin e *ndoshta-s*, kjo, si një fjalë në thelb e geg. veriore, është një huazim krahinor prej serbokr. *doista* "me të vërtetë" (*istina* "e vërtetë"). Kjo dha në të parë *dojshta*, mbi dëshminë e ndrimit *s*: *sh* një huazim mjaft i vjetër. Në pikëpamje formale do shënuar se shtesa e *n-së* niçore do të ketë shkuar pas analogjisë me disa fjalë më *ndo-*, si *ndonjë*, *ndokush*, *ndonëse*, që kanë pranë tyre dhe trajta paralele me *do-*, si *donjë*, *dokush*. Po pavarësisht nga kjo, në gjuhën shqipe ekziston prirja për shqiptim të një *n-je* para një *d-je* a një *g-je* në ballë të fjalës, sh. dhe *ngërmoj*. Në grupin trekonsonantik *-jst-* u zhduk *-j-ja*; khs. *mashtraj* nga *majshtronj*, *vosht* nga sllav. *vojsht-*, i *mashhtë* nga i *majhtë*: i *majtë*. Për kuptimin do vënë re se një kalim nga "me të vërtetë" në "mbase", si duket, nëpër një shkallë të ndërmjeme "ka të gjarë, pas gjase", nuk është për të çuditur. Kemi të bëjmë me një dobësim kuptimi, afërsisht ashtu si në gjerm. *fast* "pothuaj, gati": *fest* "i fortë", gr. *μάλιστα* "më fort" e "afërsisht" etj., sh. Walde-Hofmann I 480. Ndërkaq për kuptimin e *ndoshta-s* nuk përjashtohet dhe një ndikim nga ana e serbokr. *možda* "mbase, mundet". — Shqipja për të dhënë kuptimin e "mbases", përveç të huajve *belqim bejta* e *ndoshta*, ka dhe disa fjalë vendi, që më të shumtat kanë dalë prej fjalish: *druese druse drosna*, *klase*, *mbase thomse*, *oce*. Sh. këto; khs. përveç F. Konitzës e Shp. Bardhit, edhe Lambertz KZ 53,287. Për gjuhët e tjera tani sëfundi dhe W. Horn, Archiv f.d. Stud. d. neur. Sprachen 187 (1950) 75.

ndrydh "nxjerr vendit, përdredh" (një eshtër, dorën); shtyp, ngjesh (brumë); *ndrydhem* "shtrembërohem, përdridhem", *u ndrydh foshnja në djep*; shtypem". Pas G. Meyerit 301 nga një lat. **intrūdo*, e *shtrydh* nga një **extrūdo*, kompozita të *trūdo* "shtyp". Spiegimin e *shtrydh* e pëlqen Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I² 1046). E vë në dyshim Tagliavini 261, duke theksuar se në gjuhët romane fjala latine ruhet vetëm me trajtën **extrudicare*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Gazulli ka verbin me *ndryçë* "me shtypë, me ndrydhë", njëkohësisht duke shënuar se Tasi e ka për "grumbulloj, mbledh, rras", e mbiemrin (bukë) e *ndrydhët* "e papjekun, e pakullueme mirë". Fjal. i

gju. shqipe ka *dardhë e ndrydhët* "e ndulgët prej së ndrydhuri" pranë *dru e drydhët* "dru që punohet lehtas me zdrug". Meqë *y-ja* në një të tillë rreth konsonantesh ka dalë nganjëherë prej një *i-je* (sh. *ndryqem*) dhe meqë *ndrydh* do të thotë dhe "përdredh, shtrembëroj", ka të gjarë që të ketë rrjedhur nga një formë me *-i-* e fjalës *dredh*, si nga mediorefleksivi *dridhem*, nga imperativi *dridh* etj. Me të vërtetë, Cordignano ka me *dridhë* "contorcere, me përdredhë" e "ammaccare, me mbretë, me ndrydhë, me shkelë". Në këto rrethana *ndrydh* paraqitet si një faktitiv-kauzativ (o intensiv) i *dredh*, me *n-* nga një *en-*, pra si një "bëj të përdridhet" ose "përdredh keq", afërsisht ashtu si *ndjek*, *ndrag*, *ndryqem* Te *ndrydh* nga *dridh-* kemi një labializim të *i-së*, ashtu si te *krymb*, *ndryqem*, *ngrysem*, *i zyntë*. Për kuptimin khs. kors. *sbulitura* "ndrydhje" nga lat. *volvare* "me rrokullue", Meyer-Lübke REW 9443. Forma *shtrydh* është formuar nga *ndrydh*, ashtu si *shtryqem* nga *ndryqem*, pas skemës *ngarkoj*; *shkarkoj*, *ngatërroj*; *shkatërroj* etj. Kështu nuk mbetet vend për bazat e rindërtuara latine **intrūdo* e **extrūdo*, sh. dhe Revue de Linguistique VII 1 192.

ndryqem "shpihem"; *shtriq* "shtrij krahët, kur ngrihem nga gjumi, kur jam i lodhur, a kur më shtypin ethe"; *shtriq këmbët* "shpij këmbët"; *shtryqem shtriqem* "shpihem"; *shtriqem rrënjët e lisave* "shtëllisen, shtrihen". E paspieguar te G. Meyeri 301. Interpretimi i Bugges (Bezenbergers Beiträge XVIII 181) nga një lat. **intuberculare* nuk qëndron nga asnjë pikëpamje. Kryesisht për arsye semantike nuk mund të mbahet as afrimi me *dru drj*, lat. *durus* etj. që bën Bariçi (I 58), duke u nisur nga një domethënie e parë "bëhem i fortë, i shtangët e i drejtë si një dru".

Është forma refleksive e *ndreq*, që përveç *ndreqem* (formë analogjike) bën me metaforën rregullisht *ndriqem*, ashtu si *heq hiqem*, *shes shitem* etj. Kështu e ka shqipja e Greqisë: *prë dizët e gjashtë vitëra u-ndriq ki naoi* "për dyzetegjashtë vjet u ndreq (u ndërtua) ky tempull" (Gjoni 2,20, te G. Meyer Alb. Studien V 49). Te *ndryqem* ka një labializim të *i-së*, sh. *ndrydh*. Te *shtryqem -t-ja* është analogjike, pas modelit të opoziteve si *ngatërroj*; *shkatërroj*, *ndrydh*; *shtrydh*, *ngarkoj*; *shkarkoj* etj.

ndryshk m. ; *ndryshk* "e lë të zëjë ndryshk"; *ndryshkem* "zë ndryshk", edhe figurshëm, "mykem". G. Meyeri (f. 76 te *dryshk*) nisat nga verbi, dhe e spiegon këtë *ndryshk* nga një lat. **inrussico*, prej *russus* "i kuq", meqë ndryshku në shumë gjuhë e ka emrin prej së kuqes; *-y-ja* e shqipes prej *u-së* së shkurtër latine mund të ketë rrjedhur sipas tij nga *-i-ja* e dytë e **inrussico*.

Fjalë e mbarë gjuhës, që përdoret si *ndryshk* e si *dryshk*: Buzuku (XLI/2, Mateu 6,19 e 20) *E mos vini ar mos vistar këha mbë këtë jetë, qi tenja e bre e të ndryshkëtitë, e qi kusarëtë e nxjerënë e vjedhënë. Ma vinie arë e vistarë mbë qiellt, tek as tinja as të ndryshkëtitë nukë e bre* "Nolite thesaurizare vobis thesauros in terra, ubi erugo et tinea demolitur, et ubi fures effodiunt et furantur. Thesaurizate autem vobis thesauros in caelo, ubi neque erugo neque tinea demolitur". Budi (DC 117, SC 194, 227) *posi krymbi drinë, e posikur zgerbeja petëkunë, o dryshku hekurinë ; aqë fort qi e verbon e e ndryshk të kthjellëtitë e mendsë nieriu; Mos e mbëlidhi veti vistarrë përmbi dhët, ke e bre dryshku e zgerbeja, e e rëmonjënë kusarëtë, me e vjedhunë, po atje nalt mbë qiellt, ke as kusar as dryshk as zgerbë s mun i afronetë*, edhe DC 77 *lëshon . . . ndo niegullënë me vrug, e ndryshk* (gabime shtypi niegullini, *ndryuk*). Bardhi Rubigo *Dryshk*, Rubiginari *Me u dryshkunë*. Bogdani (I 59, 16) *Jevrejët, Heretikëtë e të ndryshkunitë ndë mpkat* "Ebrei et Heretici e Peccatori ostinati". Weigandi ka *dryshk*, Gazulli (HD XVII 548) *ndryjk*, A. Sirdani (poaty XVI 495) *à ndryshkue për gjumë* "e ka lodhë gjumi". Arbëreshët e Italisë thonë *ndrishk*: te G. Kamarda f. 20 *Mos ngreni për jū tërsore mbi dhë: ku kopica,*

edhe ndrishku i gris; Fjala e t'in Zoti (II Nr. 8, f. 3) e *zilia e gr̄j n'dita n'dita si ndrishku gr̄n hekurin*. Në Borgo Erizzo *ndrushk*. Zgjerim me *-ull* është *ndryshkull* m., që shënon bimët *Euphorbia cyparissias* (qumështore) e *Dicamnus albus*. — Ashtu si te *fruth* (sh. këtë), edhe te *ndryshk* kemi refleksin e fjalës indoeuropiane për "i kuq" në gjuhën shqipe. Të dyja janë forma me prefiks: *fruth* me *f-*, *dryshk* me *dë-*, si *dëborë: borë, dërrasë: rrasë*. Trajta *ndryshk* në çdo rasë është sekundare, me një *n-* që mund të ketë rrjedhur në disa mënyra: o si shtesë thjesht fonetike në ballë të fjalës (si *ndokush* etj. nga *do-*, khs. *mb-* nga *b-*); o nga lidhja në *dryshk*, si *mnot* nga *më not*; ose *ndryshk* është *-më fort*- trajta e verbit, një faktitiv-kauzativ me *n-* prej indoeur. *en-*, me kuptimin "e bëj të ndryshket". Për bazën e fjalës do thënë se, krahas me *f-ruth* që paraqet një indoeur. **rudh-*, *nd-ryshk nd-rushk* është një formë e zgjeruar, brenda shqipes, me *-shk*, sufiks që tregon përgjasimin (e *zeshkë: e zezë*), pra një mbiemër "si i kuq, i kuqlemtë", që u substantivua, khs. të *ndryshkëtitë* e *Buzukut*. Kjo analizë tregon se emri ka qenë *dryshk* dhe verbi *ndryshk*, afërsisht ashtu si i ka Budi, dhe se forma me *n-* prej verbit hyri tek emri. Nuk përjashtohet ekzistenca e një baze më të përparme **nd-rydh-shk nd-rudh-shk*, ku në një grup tri konsonantesh ra spiranti dental. Për bazë parashqiptare, në qoftë se primare është *ndrushk*, do të marrim një **rudh-* si te *fruth*; po në qoftë se është *ndryshk*, baza ka qenë një **rudh-*, shkallë që qëndron ndaj *fruth* në raport të apofonisë kuantitative. Etimologjikisht *ndryshk* afrohet kështu me lat. *ruber* e *russus*, gr. *ῥυθρός*, lit. *raūdas*, gjerm. *rot* etj., që shënojnë të kuqen ose variacionet e saj. Për kuptimin e veçantë të *ndryshkut* khs. nga kjo familje fjalësh lat. *robigo* "ndryshk; urth i grurit" (khs. *vrug, e ndryshk* te Budi), gjerm. *Rost* let. *rūsa* "ndryshk", si dhe it. *rugine* (*del grano*) e frgj. *rouille*, që edhe këto kanë të dyja kuptimet.

nduk "terheq; piskoj; shkull (puplat e një shpendi), rjep (një pulë)". Sikundër e pa G. Meyeri (f. 301 v.), është e afërt me lat. *dūcō*, kymr. e vj. (kelt.) *dygaf* "tërheq, sjell", got. *tiuhan* gjerm. *ziehen* "me tërheqë" e mbase edhe me gr. *δαιδύσσειν* *ἔλασσειν* të Heziku. Khs. dhe Walde-Pokorny I 781, Ernout-Meillet 287, Walde-Hofmann I 377, Kluge-Goetze 710, Pokorny I 220, Hofmann GEW 50.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku (XIII, Psalm 128, 6; LVI = LXVI, Isaia 50, 6) *Klofshinë pors bari qi lindetë përmbi shtëpit, qi parë se vjen ndukunë anshtë përvëluotë* "Fiant sicut foenum tectorum: quod priusquam evellatur, exaruit"; *U dhac korpnë tem për të nvoratë, e faqetë e mi atyne qi më nduknjinë* "Corpus meum dedi percutientibus, et genas meas vellentibus"; Bardhi *Vellicare Me ndukunë, me piskue*. Ky kuptim është i përgjithshëm. Për Jugë khs. Pedersenin 108, 166, për Veri Junggun e Bashkimin ("strappare, sveltere") bashkë me postverbalin *ndukë* f. "një bashkë lesh", Leka (XV 79) *pulë e nukët, Gazulli me ndukë leshin* (tue tjerrë) = gjerm. "zupfen", *ndukë leshi* "bashkë leshi"; Kristoforidhi "μαδάω", ashtu më parë dhe Kavalioti (te G. Meyer. Alb. Studien IV 80). Ndërkaq në tosk. jugore fjala ka edhe kuptimin "tërheq, tërheq me forcë" (një litar, një njeri prej krahu, prej xhakete etj.); prej këndeje duket të kenë dalë domethëniet "piskoj" e "shpuploj, rjep një pulë", si përdorime drastike. Kështu fjala e shqipes puthitet më së miri me lat. *dūcō* e got. *tiuhan* gjerm. *ziehen*. Morfologjikisht *n-duk* është formuar me *n-* nga *en-* (Buzuku *nduk*), e krahasueshme nga kjo anë me lat. *indūcō*. Ndërkaq *nduk* fonetikisht reflekton një bazë **dukō*, prandaj nga kjo anë afrohet më fort me kymr. e vj. *dygaf*, e cila pasqyron pokëtë shkallë apofonike me *u* të shkurtër.

ndulket "thuhet për disa pemë (dardhë, vadhë etj.) që, si janë vjelë pa

pjekur, lihen të piqen vetiu"; *i, e ndulkët* "pjekur vetiu, si të jetë këputur prej peme" (për dardhë etj.); edhe *ndyket, ndujket, nduget, i ndugët, nylkur ndylkur*, në anët e Gjakovës *duget, i dugët*. Pas G. Meyerit 313 nga lat. *dulcis* ose nga një lat. **dulculus*. Shp. Bardhi (HD XI 312v.) shënon *i nuk-të* "i qullët" (për njerëz) dhe heton raportin fonetik reciprok të formave dialektore.

Analiza e formave tregon se baza e fjalës është *dulk*, verbi një faktitiv-kauzativ më *n*-(nga *en-*), me kuptimin "bëj të ndulkët". Trajta *ndujket* paraqet zbutimin e rregullt të *l*-së në *j* përpara guturalit, si te *ulk : uj*k. Variantet me *n*- të thjeshtë, sikundër vë re dhe Shp. Bardhi, paraqesin asimilimin e grupit *nd* në gegërishten, e trajtat me *-g-* (*ndug-*) të geg. veriore sonorizimin e okluzivit të silabës fundore në këtë dialekt. Ndërkaq edhe trajta *ndulk* nuk duket të përmbajë një grup *nd-* primar. Fjala duket se vjen nga *tul*, duke qenë pemët e ndulkëta ato që kanë *tul*. Pra forma bazë duhet të ketë qenë një emër **ntulk* o një mbiemër **i ntulkët*, zgjerim me sufiks nominal *-k*, për të cilin sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 63. Andej dolí verbi. Variantet me *-y-*, *ndyket nylkur* etj., rrjedhin nga ndrimi *u : y*, i shpeshhtë nëpër dialektet e shqipes.

ne "te, tek". Parafjalë që përdoret me emërore. Mungon te G. Meyerit. Sëpari te Pedersen (f.166v.) : *ne prinzipai; u bë sevdalli ne nusët; ne hani*: "para fjalëve që shënojnë persona, "te, tek"; me kuptim lokal sinonim me *në*". Te fjal. i gju. shqipe *shkoi ne i vëllai, rri ne i biri*. Pedersen i jep edhe *nek nekë*, me përdorimet: 1. = *ne : nek ai mulli; nek mua; nekë tij*; 2. "ku": *nekë ishnë gurë; nek kish punënë; atje nek ish kalivja*; 3. "ndërsa, kur": *nek i shpuri lagjënë me ujë; një mbrëma nekë flij*; 4. "në vend të": *nekë t'e vëmë në dhe të gjallë*. Këto shembëlla tregojnë se *ne* përdoret njësoj si *te*, e *nek* njësoj si *tek*. Ato edhe etimologjikisht janë një me këto. Më saktësisht *ne* ka dalë nga një përzjerje e *te* me *në* që janë sinonime me të; *nek* nga *ne*, duke iu shtuar *-k*-ja e *tek*-ut, ose nga një përzjerje e *tek*-ut me *në*.

nesër; *i nesërm*; të *nesërmen* "një ditë më vonë", e *nesërmja* f. "e ardhmja"; *nesërejt nesërejt nesëret* "më nesëret, të nesërmen"; *pasnesër, i pasnesërm*; në Siqueli *nes mbrëma, më nesa*. Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyerit (f. 303, Alb. Studien III 13,88, IV 23) sheh te *nes*-refleksin e një indo-eur. **nōk-*, me *k* palatale, duke e vënë fjalën shqipe në lidhje apofonie me osk. *nēsimo-* "më i afri", irl. e vje. *nessa* "më afër", got. *nēhva* "afër", ind e vj. *nāsati* "ja mbërrin". Rezerva të Brugmann (Grundriss I² 148, Ber. d. K. Sächs. Ges. d. Wiss. Phil. — hist. Kl. 69, Idg. Anzeiger 1,118). Pedersen i përkundrazi (Bezenbergers Beiträge XX 236v., KZ 36, 336, Kelt. Gram. I 123) mendon dhe për *nesër* një zhvillim kuptimi nga "në mëngjes heret, me natë" në "nesër", ashtu si e ka dhe gjerm. *morgen*; kështu e spiegon fjalën me mjetet e brendshme të shqipes, nga një **noktio*; më konkretisht nga një **nati-herë*, si të thuash "në natë here". Spiegimin e tij e pranon Walde-Pokorny I 129 (sh. dhe II 328) e Tagliavini 204; sh. dhe Pokorny I 317. Bariçi (I 58 vv.) e zbërthen fjalën në *n-esër*, duke afruar këtë **-esër* me gr. ἠώς "agim" lit. *aurà* "akshand i dritës" etj., e përbrenda shqipes me *sillë*, me *esëll* e eventualisht dhe me *agon*. Etimologji e kundërshtuar te Tagliavini, më parë te Vasmeri (Studien I 45v.). Edhe ky dijetar nisat nga një kompozit me *-herë*, po te *nes* sheh refleksin shqiptar të një baze indoeuropiane *(e)n *ōku* "së shpejti"; po sh. Bariçi, Arhiv za arb. starinu I 216.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Ungjilli i Pashkëvet, më i moçmi tekst i toskërishtes: *ei men eser kjai eser* "τῆ δέ ἐπαύριον" (Borgia, Pericope evangelica in lingua albanese 27), me ndarje të gabuar të fjalëve. Buzuku

(LXXVII/2 = LXXXVII/2, Mateu 6,30) *E sana e fushësë qi sot anshtë e nesëret vete gjithë nde e djegunë* "Si autem foenum agri, quod hodie est et cras in clibanum mittitur". Budi (DC 34, 170) *e nesër mbasi të sosnjëmë oficienë; e nesëret mbas dreke; e pret . . . e sot mbë nesër*; Bardhi Cras *Nesërë*, Perendie *Mbasnesërë*. Në Çamëri, në Greqi e në Itali *nestrë nestr*, me *-t-* si shtesë fonetike në grupin *sr*, sh. Pedersen 167, Laographia I 94, Kamarda I 309. — Për etimologjinë do vënë re, me Ernout-Meillet 227, që nuk ka në fushën e gjuhëvevët indoeuropiane një fjalë për "nesër" që të gjindet në dy nga këto gjuhë. Në shumicën e këtyre fjalët për "nesër" kanë dalë nga emri i mëngjesit, si gjerm. *morgen* : *Morgen*, sllav. e vj. kishtare *za-utra* nga *utro*, gr. *αὔριον*: lit. *ausrà* "akshand i dritës" etj.; khs. tani sëfundi dhe G. Cotton, "Matin" > "demain". Essai d'explication du latin *cras* (Les Etudes Classiques, Namur, XX, 1952, 157 vv.) Kështu ka ndodhur dhe në shqipen, sikundër e vuri re Pedersen. Edhe duke lënë mënjanë *mirenestrassë* "guden morgen" të Arnold von Harffit (1497), e cila mbetet e dyshimtë, meqë mund të jetë *mirë nestrasë* ose *mirë neshtrasha* (sh. *neshtrashë*), mbeten rasa të tilla si ajo e Ungjillit të Pashkëvevët dhe *Jobi ngrihej herët ndë nesëret* te Kristoforidhi (Istoria e shkronjësë shënjtëruarë 37). Për spjegimin e fjalës do vënë re ndërkaq se shqipja idenë e mëngjezit përveç se me *natë* e jep dhe me anë të fjalës *esëll*. Kështu Budi (RR 76) *ka ndërë nesëret përtesëllë*. De Rada (Poesie albanesi V, libri IV, Historia IV 10; VI IV 55) *çë për s'ësuli* "që me *natë*"; *për s'esul*, përkundrejt *nestrë menatë* "αὔριο τό πρωί" të Atikës. Kështu *nesër* është *n esëll herë*, e *nesëret* është *n esëll heret*, me *n-* si sllav. *za utro*, rus. *zavtra* "nesër". Për përdorimin e shpeshtë të *herë-s* në të tilla kompozita lidhur me ditën e me *natën* khs. përveç *nesër* më *zëmër-herë* të Pedersenit, edhe *në drekë-herë*, *në darkë-herë*, e Bardhi Vesper *Mbârherë*. Sh. dhe *caherë*, e khs. edhe shq. *rallëherë*: rum. *rareori*. Kështu *nesër* është një nga formimet e shpeshta me mjetet e brendshme të gjuhës.

nëse "në, në qoftë se, në është se". Mungon te G. Meyeri. Sikundër e shënon Lambertzi (IF 34, 50 e 115), del që me poezinë popullore arbëreshe, te Kamarda (A Dora d'Istria gli Albanesi 81, kënga e Garentinës). *Ndë se kam të vijn ndë lip, Vete vishem ndë të zezat. Ndëse vijn pra ndë xarë, Vete vishem ndër të xollat*; në Kalabri dhe *ndë qe: ndë qe u mund të bëjë*. Ka dalë në ngërthim të fjalës nga *në se*. Te Pedersen (f. 167) këto dy pjesë janë larg e larg: *i thotë, që në dij birbil gjizarin, se ku ish*. Modeli ekziston dhe në traditën letrare, veçse me topikë të përkundërt, te Buzuku se . . . *në: E se ajo në u haroftë, u nukë haronem në teje* "Et si illa oblita fuerit, ego tamen non obliviscar tui"; *E se gjithë në u skandalixojsinë në teje* "Etsi omnes scandalizati fuerint in te" (LIX, Isaia 49,15; LXIV, Mateu 26, 33). Kjo topikë më vonë edhe te Grigori (Mateu 6,1): *se ndë bëfçi ashtu*. Veçse këtu dy pjesët përbërëse vijnë pandërmjetësisht një pas një; dhe *se* këtu është shkakore. Mundet që formimi i *nëse* nga *në . . . se* të jetë i pavarur nga *se . . . në*.

ngalem "s'eci dot, më janë zënë këmbët; jam i penguar nga punët"; *ngel* "mbëtem; ndal"; *ngalój ngalohem* "jam zënë këmbësh"; *ngalakág* "i ngadalshëm në lëvizje e në të ecur, i plogët"; *ngalosem* "ngalem", *dhitë u ngalosën* "mbenë me barrë", kal. *ngal'ós* "ngatërrohem në diçka", *ngal'osi me barr* "mbeti me barrë". Pas G. Meyerit 305 nga it. *incagliare* "me pengue; me ngelë". Në këto ujëra shkon edhe Helbigu 23v., veçse ky lëkundet midis it. *incagliare* dhe një lat. **incalleare* "me vu për rrugë". Kundër këtij spjegimi silllet Gelzeri (Z.f. rom. Phil. 1913, f. 262) me Spitzerin (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 142 shën. 1), duke u nisur ky dijetar i fundit nga një bazë latine **incallare* e duke afruar fjalën shqipe me kat. *encallarse*.

Fjalë me degëzime të shumta, formash e kuptimesh. Nga *ngal-*, *ngalem*

janë formuar emrat *ngale* m. "çark i pushkës", *ngalëz* f. "ngatërresë" (Shp. Bardhi HD XI 312 për Krujë *ngalsë* f. "ngatërresë gjaku a çdofarë dhune ose borxhi me ndokend a me qeverri"), *ngalosë* f. "hikrraq, zbeqth" (në të folët e Elbasanit i *zu dhitë ngalosa* e *dhitë u ngalosën*), mbiemri i *ngalët* "që mezi ecën, i ngadalshëm"; nga *ngel* ka dalë *ngel* m. "ngërc", *ngelac ngelac* "i ngalët, i ngathët". Pedersen 170 ka *ngaløj* "mbuloj". — Etimologjia latine o romane qoftë nuk është e mundur, se një bazë e andejme do të kish dhënë **ngajoj*, sh. dhe Revue de Linguistique VII 1 193. Format *ngalem ngel*, pa zgjerim me sufiks, tregojnë se kemi të bëjmë me një nga formimet e moçme të fondit autokton, për të cilat sh. Jokl Slavia XIII 299. Në këtë klasë verbale nuk kanë marrë më pjesë huazimet latine, si pat vënë re Pedersen (Roman. Jahrecberisht IX 1 211). Nga të dy trajtat *ngal-* e *ngel*, ajo me *a*, si zakonisht, është primarja; e dyta sekundare, metafonike, ashtu si *derdh* ndaj *dardh*, *shkel* nga *shkal*. Pra forma bazë e fjalës është *ngal*. Për këtë ndërkaq nuk qëndron spjegimi i Ostirit (Anthropos VIII 165vv.), i cili e lidh me *gul* "shtyt, pa bri", sepse përveç së tjerash ai spjegim nuk ecën as nga kuptimi. Mbase e afër me lat. *callum*, sll. *kaliti* etj.

ngallmój "mbërthej me gozhda; ngas, gërgas" (*mos më ngallmoj*); *shkallmój* "zbërthej me fuqi një gjë të mbërthyer me gozhda" (*shkallmoj derën*), figurshëm "dërmoj". Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri 305 e spiegon nga it. *incalmare* "me shartue", po më fort nga një lat. **incalamare*, duke krahasuar për kuptimin serbokr. *nakalamiti* "me shartue". Jokli (LKU 269), duke u nisur nga kuptimi "mbërthej", e afron verbin brenda shqipes me *akull*, e bashkë me këtë më tej me sllav. kishtare *kaliti* "me ftofë, me kalitë hekurin", serbokr. *prikala* "ngricë".

Del sëpari te Budi (DC 197b): *Qelbetë korpi i tyne, Gjymtyrëshit çkallëmuom*. Kristoforidhi jep për gegërishten *ngallmój* e *ngallëmój* me kuptimin "πειράζω. ἐθελίζω", Bashkimi *ngallmój* "assordare, sollecitare, dare ansa o irritare", Weigandi "sticheln, necken, stören, lästig fallen". Ky përdorim dhe te Bageri (f. 24): *Njëherë njerëz të liq ngallmojn qyverin*. Cordignano ka me *ngallnue* "molestare, seccare, punzecchiare, stuzzicare, assordare, sollecitare, dar ansa a . . .", po edhe për "me merthye kllap në kllap", *me ngallnue një tryezë* "metter insieme le parti di un tavolo", veçse kjo mund të jetë gabim shtypi për *me ngallmue*. — Etimologjikisht *ngallmój* nuk mund të shkëputet nga *ngallon* "lëshon (gruri) kalli; mbin, nxjerr ngallica" *ngallis ngallita* "mbij; gërgas, ngacmój" (Junggu me *ngallit* «aizzare») të cilat lidhen me *kall* kalli-un. Prej "qes ngallicë" u zhvillua më një anë "mbërthej me gozhda", më anë tjetër "ngas, gërgas", kjo nga një më konkrete "shpoj, thumboj, ther me thumba". Për zhvillimin kuptimor khs. sllav. e vj. kishtare *klasъ* "kalliu" që e afrojnë me *kolo klati* "ther, shpoj, thumboj" e përjashta sllavishtes pikërisht dhe me *kalli-un* e shqipes (Berneker I 549, Vasmer REW I 603 me literaturë); për *ngallmój* "mbërthej me gozhda" khs. lit. *kälti* "me mbathë" që është afër me fjalët sllave, Fraenkel 212. Morfologjikisht *ngallmój* paraqitet si një denominativ më -*oj* i *ngallm-it*, të cilin Manni e jep me kuptimin "bezdi". Po mundet që *ngallmój* të jetë një zgjerim i *ngalloj* me infiks -*m-*, mbase në analogji me verbe si *shqelmoj*, *ngulmoj*. Opoziti *shkallmój* pas skemës së verbeve çift si *ngarkoj shkarkoj*, *ngatërroj shkatërroj*, *ngul shkul*. Në çdo rasë guturali i zëshëm te *ngallmój* është sekundar, ashtu si te *ngalloj*, *ngallicë* etj. Ka dalë nga asimilimi i *k-*së ndaj preverbit *n-*, refleksi i një më të vjetre *en-*. — Sh. dhe *ngallon*.

ngallón "lëshon (gruri) kalli; mbin, nxjerr ngallica"; *ngallë* f. "rabush; mashkulli i qepës"; *ngallim* m. "filiz, njomëz"; *ngallëc* m., *ngallicë* f. "filiz, njomëz, rabush, mashkulli i qepës", *ngallë*; *xhufkë* e *misrit*;

figurshëm "grua pishëvënë"; *ngallis* (*ngallita*) "mbij: purritë kanë ngallitë; gërgas, ngacmoj"; *ngallitës* m. "ai që ngacmon, që gërget"; *ngalle* m. "filiz i qepës"; *ngallinë* f. "escrescenza di porro sulla pelle degli animali o scorza dei vegetali (*me qitë ngallina*)". Mungon te G. Meyeri, e pastudiuar gjer më sot. Është fjalë e mbarë gjuhës, sepse e ka edhe Bregu i Detit (Borshi), u *ngallua bari* "u trash e u prish" (M. Totoni). Te *ngalloj* kemi një verb denominativ të *kall-it* "kalliu", pra "qes kallium", kompozuar me *n-* (nga *-en-*), e cila solli asimilimin e *k-së* në *g*; dhe me të vërtetë, Gazulli pranë *me ngallue* jep për Malsi të Madhe *me kallue* "me qitë kallin, me qitë ngallicën", e pranë *ngallec-it* jep *kallec*. Nga *ngallon* u asbrahua një temë e re *ngall-*, me të cilën u formuan *ngallë*, *ngalle*, *ngallim*, *ngallicë*, *ngallinë*, *ngallis*. Prej *ngallicë-s* ka dalë verbi me *ngallicue* "me qitë ngallicën". U formua dhe nga *ngallm*, që dha *ngallmoj* (sh. këtë fjale). Për kuptimin "ngas, gërgas" khs. sllav. e vj. kishtarë *klasъ* "kalliu": *kolo klati* "ther; shpoj, thumboj" (sh. *ngallmoj*). — Sh. dhe *ngacmoj*, *ngullon*.

ngarënd "vrapij, harboj". Fjalë e gegërishtes, mungon te G. Meyeri. Është një nga ato verbet e shqipes që kanë dalë nga univërbimi i një verbi me një emër (*ngas rend*): verbe "delokutive" si i quan tani rishmë E. Benveniste (Studia in honorem L. Spitzer, 1958, f. 57 vv., sh. edhe F. Dimitrescu, Studii si Cerc. lingvistice XII 3 (1961) 107vv). Shqipja ka disa verbe të tilla: *ngarënd*, *bzaj bëzëj* (*bâj zâ, bëj zë*), *orej* (*oë re*), sh. këto fjalë. Në një fazë më të parë ruhej lokucioni: Bardhi Currere *Me fuguem, o me ngam rend*; Bogdani (I 35, 12; II 132, 9) *nget rend Dielli* "corre il sole", *ngau rend* "vi corse". Morfologjikisht *ngarënd* është një jukstapozicion, ku *rend-i* është "vrapi".

ngastër f. "një pjesë e byrekut a e lakrorit; krahinë, rreth; lagje". G. Meyeri (f. 2 4) e merr prej S. Frashërit si *ngasëra*. pl. «lagjet e një qyteti» dhe e bashkon me verbin *ngas* "prek, cys", pa shpjeguar ndryshimin e kuptimeve. Leotti jep edhe *gastër* "fetta", Manni edhe *ngasër* "cake", Tase *gastër* e *ngasër* "pjesë, copë", një *gastër lakruari*; në Lunxhëri "shapkat". E toskërishtes është *punon për një ngastër bukë*. Kuptimi i parë është "copë", përdorimi "krahinë, rreth; lagje" është më i vonë. Atë të parin ruan dhe verbi denominativ *ngastroj* "copëtoj", te Dielli (I Nr. 33, 12.11.1909 f. 2, II Nr. VI= XVIII, 1898, B — 78) që *Shqipëria të ngastrohet, . . . ta ngastrojnë*. Rrjedh prej gr. së re *γαστρα* "garrac, saksii lulesh", nëpër shkallët "saksii e thyer", "copa e një saksie të thyer", "copë", në arbërishten e Molizes *gastë* "saksii lulesh (Lambertz KZ 53, 287)". Në thelb identike me *gastare*. Te *ngastër n-ja* është shtesë fonetike, si te *ngerç*. Për përhapjen e fjalës greke khs. Meyer-Lübke REW 3700, Rohlf's EW 417. Përhapja e fjalës në toskërishten dëshmon edhe kjo burim i saj prej greqishtes.

ngatërroj "ndërlik, pështjelloj"; *ngatërrî* f.; *ngatërrim* m.; *ngatërrësë* f., *ngatërrësitar* m.; *ngatërr* f. "kordelë për të lidhur gërshetat"; *shkatërrój* «prish, rrenoj; zbledh një lëmsh a zgjidh një punë të ngatërruar»; *shkatërrim* m. *shkatërrimtar* m.; *shkatërrësë* f.; *shkatërrinë* f. "ndërtësë e vjetër gati më të rrëzuar, shpartallinë, karakatinë"; *shkatërraç shkatërraç* "njeri i shkatërruar në punë e tij"; *shkatërr* : e la *shkatërr* "e la të shkatërruar (shtëpinë), të pazgjidhur (një çështje)". G. Meyeri 305 e bashkon brenda gjuhës me *ngath ngathem* "mpihem" e më tej me *ingattiar ingategiar incatigiar* "me ngatërrue" e *scattià* "me gafrue, me shpupurishë (flokët)" në dialektet italiane të veriut. Spitzeri (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 325) *ngatërroj* e çon te një bazë latine e rindërtuar "inquaternare, e shkatërroj te një "exquaternare, pra "mbledh më katër", "ndaj katërsh". Ai silltet kundra Helbigut, i cili (f. 75, 121) për *ngatërroj* i mbahet mendimit të G. Meyerit, e për *shkatërroj* mendon si burim një it. *scatarrare* "me hudhë jashtë". Bariçi (I 60v.)

kërkon të gjejë te ky verb një kompozit, ku nga-, shka- përmban sipas tij parafjalën *ka nga*, dhe -tërr-, refleksi i një *-trin-, u lidhka me *shtie*, me *mbëshjtjell* e me *shtrij*, më tutje me lat. *sterno* sllav. e vj. kishtare *steljo posteljo* "στροωνύειν" etj.

Fjalë e gjuhës mbarë, në Siqeli *shkatarroj shkatarrojem* (sh. dhe Kamar-dën I 138, 195). Buzuku (LXI = LXXI, Gjenezë 22, 13) e pā një *dash qi ish ngatëruom për brienësh ndër zhdo driza* "viditque arietem inter vepres haerentem cornibus". Budi (DC 165, 199b, SC 5) e pëshjtjellë e ngatërruom nd aqë faje e mkate të pānjefuna sã ndeevonë . . . s munë shpëtonjë as munë çkatërrohetë. Bardhi Implexus, involto *Ngatërruem*. Sikundër e kemi shtjelluar dhe në *Revue Int. d. Et. Balk.* II 172vv., *shkatërroj* ka dalë nga *katër* (*shkatërroj*), formim i leksikut të jetës baritore (ndarja e bagëtisë së therur në katër pjesë) e që del dhe në shprehje të tilla si *do të bëj më katërsh!* Këndej del se më parë është formuar *shkatërroj*, e këndej si formë opozicioni *ngatërroj*, pas skemës *ngarkoj shkarkoj, ngul shkul*. Emri *ngatërr* e ndajfolja *shkatërr* janë deverbativa. — Te të dyja trajtat e fjalës, *ngatërroj* e *shkatërroj*, rr-ja rrjedh prej një geminacioni ekspresiv. Me këtë spjegim me mjetet e brendshme të gjuhës bien etimologjitetë e gjertanishme. Fjala e shqipes nuk ka lidhje me ato të italishtes veriore. I papranueshëm dhe ndërtimi i bazave latine **inquaternare*, **exquaternare* që s'kanë ekzistuar fare, bazat latine janë **exquartare* e **exquateriare* (Meyer-Lübke REW 3061, 3062), sh. tani dhe *Revue de Linguistique* VII 1 193. Nga çdo anë i padiskutueshëm është zbërthimi i fjalës që bën Bariçi. Spitzeri, ndërkaq, me gjithë ndërtimin e dy bazave latine që janë të pamundura, pati dhe një ide të etimologjisë së drejtë të fjalës, kur të pakën për trajtën *shkatërroj* (me r të thjeshtë) përsjati një burim nga *katër* ose një ndikim nga ana e saj.

ngërmó: "eys, ngas, trazoj; shtrëngo"; më *ka ngërmue për bukë* "më preu për të ngrënë"; "shtyj": *ç'më ngërmoi mue ta báj këtë punë?* G. Meyeri (f.12, të *angari*) jep një shkodr. *ngermoj* me kuptimin "përdhunoj, shtrëngo" me përdhunë" dhe këtë bashkë me një emër *ngert* f. "shtypje, ndrydhje" e nxjerr nga it. *angheria* "shtypje, shtrëngim". Nuk duket të jetë pranuar te Helbigu. Kristoforidhi (f. 261) e krahason me *gërmoj*, mendim i drejtë në thelb, sh. *Bul. për Shk. Shoq.* 2 (1954) 46.

Çfaqet që te Budi (SC 152): *kush ju ngërmoj* (ose *ngermoj*) *jū me u lidhunë nd atë* (ate) *zgjedhë qi s qetë të zotë me e hjekunë*. E ka dhe Bogdani: *e të parënë ditë shīm jashë Qiellshit, kjenë ngermuem ndë Ferrë* "e l'istesso «primo giorno cacciati dal Cielo furono rinchiusi nell' Inferno"; e *prashu do thanë se Patriarkëtë, e Profetëtë, prashu ngermoheshinë me lëvduem* "per la quale li Patriarchi, e Profeti tanto si sforzarono lodare"; *urdhënoj t'parëvet shtëpësëvet, qi ma fort të ngermojnë Popullinë e Israelit ndë punëtë tyne* "commandò alli suoi maggiordomi, che maggiormente astringessero il Popolo d'Isdraele nelle sue opere" (I 22, 6; 76,15; 89, 12). Si e kemi shtjelluar dhe në vendin e përmendur, një lidhje etimologjike midis *ngërmoj* e *gërmoj* është bindëse, kur të kemi parasysh sa i lehtë është kalimi nga konkreti "gërmoj" në abstraktin "shtyj, shtrëngo". Një kalim i tillë shihet dhe në shprehje si *mos e gërmo më atë punë* "mos e nga më, mos e shty më tutje", e m'anë tjetër sharja të *gërmojshta tët amë!* e dialektit të Elbasanit me kuptimin e mirëfilltë "gërmoj", khs. prej Gjirokastre të *rëmojshta tët ëme*: Nga "gërmoj" kuptohet dhe *m'u ngermue* "inclinarsi, incurvarsi", *ngermuet* "inclinato" te Bashkimi. Ndryshimi formal (n-) që solli në dallimin e *ngërmoj* nga *gërmoj*, duke formuar me këtë rrugë një fjalë të re, është o një prefiks analogjik më funksion intensiv, ose një shtesë thjesht fonetike. Veçoria për të zhvilluar një m- në ballë të fjalës përpara b-së (sh. *mblatë, Mborje*) ka përbri saj

dhe prirjen për zhvillim të një n-je në fjalë që nisin me një d- ose g-, sh. *ndoshita, ngastër, ngerç*.

ngërthëj "shtrengoj": *ngërthej vetullat; ngërthehen* "kapen dhëmbëzat e një rrote njëra me tjetrën"; te Lambertzi *ngërtheje kthetrat* "kthetrat gati për të kapur". Për këtë fjalë, e cila mungon te G. Meyeri, Gazulli jep për Mirditë formën *me ngërdhje* "me lidhë shtërguetas, me lidhë nye". Kjo tregon qartë se verbi është një denominativ i grupit të fjalëve *gardhë* "të ngërthyerit, të shtënë e dërrasave të fuçisë gojë me gojë", *gardhën* "vanë që bëhet poshtë te dërrasat e fuçisë për të ngërthyer fundin e saj më to", *gardhnojcë* "rrotë me thepa, që përdoret për të vënë në lëvizje një tjetër rrotë", Te *ngërthej* përkundrejt *ngërdhej* kemi një shurdhim të spirantit interdental, mbase nën ndikim të verbit *thej* me anë të një etimologjie popullore. Gurra e gjithë këtyre fjalëve është *gardh-i*, sh. Li. Posn. VII 168. Aty -a-ja u shurdhua në -ë- në silabë të pathekse, poashtu si te *Zgërdhësh* (*zgardh*). Me këtë vërtetohet se *ngërthej ngërdhej* e *Zgërdhësh* janë formime më të moçme se *gardhnojcë, Gardhiq* etj.

ngos "ngop, ngij"; *ngosem* "ngopem, ngihem". G. Meyeri 306 e bashkon me *ngop*, po i lë të dyja fjalët pa etimologji. Pedersen (KZ 36, 323) shënon se s'është e qartë pas cilës gjedhe është formuar *ngos* pranë *ngop*. Cimochowski (Li. Posn. V 194) *ngos* e lidh me *ngop* në këtë mënyrë që ai *ngos* e spiegon prej një baze **-gop-ti-ō*, duke gjetur pra aty një formim verbal më -ti-.

Është fjalë e tosk. jugore dhe e dialekteve t'Italisë. Boçari 34 e ka për "γεμίζω", Pedersen 170 *ngosem*, edhe u *ngos me ujë*; në Siqueli (Piana dei Greci) i *ngost* "stanco morto, i lodhët shumë, i këputur". Vjen prej gr. së re *ἀγκώνω* "fryj", e cila nëpër dialekte përdoret dhe për barkun e madh që vjen prej se ngrëni: *Ἰδία ἐπί τῆς κοιλίας ἐκ πολυφαγίας: ἔφαγα κί' ἀγκώδι'κα; ὀγκώμαι τὴν' κοιλίαν, οἰδῶ: ἔφαγα πολύ καί ἀγκωσα, ἔφαγα καί ἀλκωσα, Ἰστορ. Λεξικόν τῆς κείας ἑλληνικῆς I 156.*

Për kuptimin e fjalës në Siqueli (*i ngost* "i këputur") khs. *ἀγκώνω* "κάμνω τινά νά στενοχωρηθῆ, πειράζω. mërzi, nguc". Ky spieгим i *ngos* nga *ἀγκώνω* na duket më i drejtë se ai nga *ἀγκώνω*. për *ἄγχω* "mbyt" që kemi dhënë në Bul. për Shk. Shoq. 3 (1952) 50 v. = Z. f. Phonetik u. allg. Sprachwiss. IX 220. Prej *ἄγχω* spiegon G. Meyeri 12 kal. *angosinj* "mbyt". Në çdo rast të dyja fjalët rrjedhin prej greqishtes. Në këtë drejtim dëshmon dhe përhapja dialektore e *ngos* në tosk. jugore e në kolonitë e Siquelisë.

ngrys "vrër", *ngrysi vetullat; ngrysem ngrisem* "errem, vonohem, si u ngryse?; ai ku ngrysen s'gëdhiet; ngrysen ngriset" "erret, muzget, bëhet natë". E paspiëguar te G. Meyeri 307 e te Weigand 62. Jokli (Studien 64) e shpie te një bazë **n-krp-tiō*, dhe si të tillë e krahason me lat. *creper* "i mugët; i dyshimtë" *crepusculum* "muzg", fjalë edhe kjo vetë e errët për nga ana e burimit. Këtë krahasim e vë në dyshim Walde-Pokorny I 525, e përmend Walde-Hofmann I 289, po e lë jashtë Pokorny I 649. E pranon Bariçi (Glasn. Skopsk. naučn. društva 2,167vv.), duke i shtuar këtij barazimi dhe gr. *γνέφας γνόφος* "errësirë". Sh. edhe Sandfeld 241.

Fjalë sot më fort e toskërishtes e e geg. jugore, po që duket të jetë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Budi (SC 26) : *Me mos i thanë aty fjalëtë aqë të mbërshela e të ngrysëta qi të mos unë* (gabim shtypi për u?) *ndëgjonënë*. Kuptimi i parë është "errët"; khs. *ngryset=errët* "vonë, ndaj natë", *si u ngryse? e si u erre?* Prandaj kjo fjalë pas gjase i përket rrënjës indoeur. **kers-* "i errët, i ndytë" **krs-no-* "i zi": ind. e vj. *krsná-* "i zi, i errët, i mbyllët", prus. e vj. *kirsnan* "të zi", lit. *kėršas* "me njolla të zeza e të bardha, lara-lara", sllav. vj. kishtare *кръпъ* "μέλις" etj. Sh. për këtë grup fjalësh sidomos Walde-Pokorny I 428v., Pokorny I 583, Vasmer REW III 326v. me litera-

turë. Fjala e shqipes është verb, dhe ky paraqitet i përbërë me preverb *en-*, që i jep një kuptim inkoativ a ingresiv, "ponis të erret". Kështu baza ka qenë **nkris*, e cila me asimilim të rregullt të okluzivit pranë nazalit dha *ngris*. Trajta *ngrys* me *-y-në* e saj është sekundare, poashtu si *krymb* ndaj *krimb*, *ngrjdh-* ndaj *ngridh*, i *zymtë* ndaj *zi* etj. Ndërkaq e sotmja *ngris* e tosk. jugore nuk paraqet medeoimos trajtën primare të fjalës, sepse mund të jetë përfundimi i një restaurimi, d.m.th. i një zhvillimi retrograd *ngris* : *ngrys*, *ngris*. Morfologjikisht *ngris* mund të jetë formuar me sufiks *-is* (*nkr-is ngr-is*). Ky formant sipas Joklit (LKU 204, Slavia XIII 321) është i burimit thjesht shqip dhe jashtëzakonisht i shpeshtë në verbet e fondit autokton, sh. dhe *gris*, *nis*. Për historinë e fjalës do shtuar se — sikundër vuri re Meillet te Ernout-Meillet 671 — nuk ka një mbiemër indoeuropian të përbashkët për kuptimin "i zi". Sikurse e kemi shënuar dhe në Bul. për Shk. Shoq. 3 (1952) 44 = Z. f. Phonetik u. allg. Sprachwiss. IX 212, shqipja nuk merr pjesë në fjalët (dialektore) për "i zi" të gjuhëvet indoeuropiane, siç janë **il-*, **neig-*, **suordh-* e **mel-* të gr. μέλας etj., po me *zi*, *i zi*, e *zezë* paraqet një konkordancë speciale balto-shqiptare, ku mbase merr pjesë edhe keltishtja. Një tjetër fjalë e kësaj sferë është *ngrys ngris*, e cila në shqipen ka shkruar për nga kuptimi i natës, me gjithë se është ruajtur dhe *natë*, fjala e mirëfilltë e këtij koncepti. Do pasur parasysh se dhe fjala e indishtes së vjetër që është e afër me *ngrys*: *krsnâ-* "i zi, i errët, i mbyllët", me varianten *krsnī* ka hvilluar kuptimin "natë". Nga fusha e shqipes në këtë drejtim ka shkruar edhe *errët*, e cila ka lidhje me emrin *rë reja*, po që te *po erret* do të thotë "po ngriset, po bëhet natë". Edhe në rumanishten koncepti i të ngjyerit *zi* ka dhënë idenë e të ngrysurit; khs. arom. *ntunicai* "u err", u *ngrys*" te P. Papahagi XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 125 Nr. 69, Papahagi 784. — Mbase me këtë fjalë të shqipes ka lidhje dhe emri i lumit Κρίσος të Dakisë, për të cilin VI. Georgievi (Arheologia II, 1960, 21, 40), mbi dëshminë e emrit të sotmë të tij *Crisul Negru* në rumanishten, postulon një kuptim "i zi".

nguj: "mbyll brenda, blokoj"; *ngujohem* "mbyllem brenda"; *ngujim* m. "të mbeturit brenda, blokim". Mungon te G. Meyeri. Është një verb denominativ i *kunj-it*, Weigand 62, Sandfeld 74. Formim i shqipes, nga **nkujonj*, jo nga një lat. e rindërtuar **incunearē*. Primitivi me *kujue* del në një këngë popullore prej rrethit të Durrësit, sh. Kanga jonë (1961) 20. Mundësia e një burimi të brendshëm (nga *cuiu*) shtrohet dhe për rum. *incuia* "me ngujue", të cilën Puscariu EW 825 bashkë me sic. *incunari* engad, *incuner* etj. e shpie te një lat. **incunearē*; sh. dhe Meyer-Lübke REW 2392, Dict. li. rom. moderne 413. Khs. tani vrejtjet tona Revue de Linguistique VII 1 171.

ngullon "qit kallium", me *ngullua* "spigare, far la spiga"; *ko ngullua* "ka qitur kallium" (tërshëra, gruri), ka lidhur". Për këtë fjalë të Borgo Erizzos Tagliavini 206 mendon një afrim me *ngul*, fjalë që te Hahni jepet dhe me kuptimin "zë rrënjë". — Nuk është tjetër veçse *ngallon* "lëshon" (gruri) kalli; mbin, nxjerr ngallia", me ndrim *a*: (ë) : u në silabë para theksit, si te *kaptoj* : *këptoj* : *kuptoj*, *laroj* : *lurtoj*, *maraj* : *mërajë* : *murak*, *varrë* : *vurratë*, *zambak* : *zumbak*.

ngurró: "nuk vendos të shkoj më tej në një punë, jam i pavendosur, stepem"; *ngurrim* m. Mungon te G. Meyeri, e jep sëpari Bashkimi. Gazulli ka me *ngurrue* 1. "m'u ndalë, gjerm. sich aufhalten, it. arrestarsi": *deshta m'e bá, por ngurrova e laçë*, 2. "me mbetë dërdyazash, gjerm. in Bestürzung sein, it. essere perplesso, in perplessità". Është një me *ngurr* "e shtangoj, i ndal hovin" (Fjal. i gjuhës shqipe) e me *nguroj* "e bëj të fortë si

gur", e *nguros* "kthej në gur" *ngurosem* "mbetem shtang, ngrij në vend (prej frike)" që janë verba denominativa të *gur*-it. Kuptimi i parë i *ngurroj* është pra "mbetem në vend si gur, ngrij në vend". Për bigëzimin semantik khs. *me ngurue* "cessare, trattenersi" të Junggut me *me ngurue* "pietrificare, indurare" e *me ngurue* "rimanere irresoluto, trattenersi dall'indursi a dire o fare una cosa" të Bashkimit. Përkundrejt formave me *-r-* të thjeshtë, si *nguroj nguros*, ato me *-r-* të fortë, *ngurr ngurroj*, si fjalë të gjuhës afektive, paraqesin geminacionin ekspresiv të likuidës, dukuri e shpeshtë e shqipes. Lidhjen e *nguroj* me *gur* e ka vënë re dhe Kristoforidhi (f. 266), dhe kjo do shtuar etimologjive shqipe të tij, që kemi përmbledhur te Bul. i Shk. Shoq. 2 (1954) 31-51 e 3 (1954) 57-75. E shënon dhe Weigandi 62. Aq më e çuditshme është kur ky dijetar më vonë (Balkan-Archiv I 259), duke u mbështetur më ndonjë kuptim okazional e krahinor që ka *ngurroj*, si "mësyj", e shpie këtë, së bashku me rum. *incurc* "ngatërroj", te lat. *incurrere* "me u lëshue me turr", e cila nuk i mjafton as fjalës shqipe as fjalës rumune. Për këtë të fundit nuk përligjet as një burim nga lat. *obscurus* (*descure* "shtëllis" nga një **deobscurico*, Puscariu EW 514), as spjegimi nga një bazë latine **incolicare* prej *colus* "furkë" (Giuglea), pranuar te Meyer-Lübke REW 4360, te Diet. li. rom. moderne 413 e te Rosetti Ist. li. romine I⁴ 176 : lat. *colus* nuk rron asgjëkund në botën romane, veçse si deminutiv *colucula conucla* që është edhe e lat. ballkanike (sh. *kanurkëz*), e u mbulua më fort, sidomos në Ballkan, nga sinonimi *furca*. Kështu nuk ka vend askund për një **incolicare*, kur vetë *colus* mungon. Edhe kuptimisht furka ka dhënë idenë e bigëzimit, jo të ngatërimit. Me qenë se kjo e fundit shpeshherë del nga fijet e ngatërruara, del pyetja mos ka dalë *incurc descure* nga *scul* "shkul, çile penjesh", e cila pas mendimit tonë rrjedh prej shq. *shkul*-i. Në qoftë se është puna kështu, në rumanishten u formua më parë *descure*, e andej *incure*, pas modelit të çifteve opozicionale *inçhid* : *deschid*, *imbrac* : *dezbrac* etj.

ngjalë f. "*Anguilla vulgaris*". Kundra mendimit të parë të albanistëve që të ky emër shihnin një fjalë vendi, gjuhësia që prej Miklosichit (f. 15) dhe G. Meyerit (f. 308) e këtëj gjen këtu refleksin e lat. *anguilla*; khs. Pedersen BB XX 232, KZ 33, 536; 36, 283. 338, Weigand 62, La Piana Studi ling. albanesi. Varia 100 shënim, më parë Diefenbach I 49. Vështirësinë që paraqet kjo etimologji : *-a-* te *ngjalë* në vend të një *-e-*je (**ngjelë*) G. Meyerit përpiket ta mënjanojë duke menduar një ndikim nga ana e fjalës *gjallë* (vivi-para!) ose e *ngjall* "maj, bëj të majmë". Pa ndonjë ndikim të jashtëm, po me një zhvillim vetiut të *gja*-së përbrenda shqipes e spiegon diftongimin e : *ja* Pedersenit, poashtu si te *gjashtë* përkundrejt lat. *sex* etj.

Fjalë e gjuhës mbarë. Del që te Bardhi (f. 4): *Anguilla Ngjala*. Për arsye të formës *ngjalë* nuk mund të spiegotet as nga lat. *anguilla* as nga gr. ἄγγελος. Dihet se lat. *e* në gjuhën shqipe ka marrë pjesë disa herë në diftongimin në *ja*, poashtu si *e*-ja e trashëgimisë indoeuropiane (*gjashtë* : lat. *sex* gr. ἕξ, i *djathtë* : lat. *dexter* gr. δεξιός, *mjaltë* : lat. *mel* gr. μέλι etj.): lat. *cerrus* : *qarr*, *fabella* : *fjalë*, *sella* : *shalë*, *serra* : *sharrë* etj. G. Meyer Alb. Studien II 21, III 84v., Gröbers Grundriss I § 11, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1044. Po nuk ka *e* dalë prej një *i*-je, as nga të fondit indoeuropian o paralatin (grek) as nga të elementit latin, që të ketë marrë pjesë në diftongimin *je* ose *ja* që ka pësuar *e*-ja origjinale; khs. *kreshtë*, *letër*, *mëshë*, *peshk* etj. Kështu *ngjalë* nuk është lat. *anguilla*; khs. përkundrazhi *shkëndije shkëndilë* që e nxjerrin nga lat. *scintilla*. As është gr. ἄγγελος, si për punë të akcentit, si të likuidës. Pra do kthyer në një farë mënyre te Hahnit (I 240) që spiegonte emrin e fisit ilir Ἐγγελαίς Ἐγγελάνας me shq. *ngjalë*. Drejt e pa punën edhe Stieri (Nr. 150): "Në këtë mes fjala e shqipes . . . nuk është nevoja

të jetë marrë hua (prej gjuhësh së tjera) — pretendimet e greqishtes e të botës romane, për punë të vështirësive fonetike të dyanshme, afërsisht barasonen në mes tyre, — po ajo ngjitet më lart në lashtësinë e saj, dhe për këtë mendim flet edhe *a-ja*". Edhe Kamarda (I 36) e krahason fjalën me gr. ἔγγελλος. Si e kemi shtjelluar dhe gjetkë (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 1, 1962, 224, VII Congr. Internaz. di Scienze Onomastiche Firenze — Pisa 1961 248v., Revue de Linguistique VII 1 184), *ngjalë* është një fjalë vendi e shqipes, refleksi i një baze **engëlla* ose **angëlla* (me *l* geminate). Kësaj nga koha antike edhe pas mendimit tonë i përgjigjet emri i fisit ilir Ἐγγελλᾶνες, banorët e brigjeve të liqenit Lychnitis (Ohrit) aq i pasur në peshk, të cilin emër Kretschmeri (Einleit. in die Gesch. d. gri. Sprache 271 shën. 1) e merr me të drejtë si një ofiq "njerëzit e ngjalës". Khs. tani për këtë emër dhe A. Meyer Die Spr. d. alten Illyrier II 45. Diftongimi i *e*-së së brendshme në *ja* dhe afereza e vokalit nistor janë kryer te **engëlla* (**angëlla*): *ngjalë* në periodën paslatine të shqipes. Në fushën indoeuropiane **engëlla*: *ngjalë* afrohet me gr. ἔγγελλος, lat. *anguilla*, lit. *ungyr̃ys* prus. e vj. *angurgis* rus. *ugorь* "ngjalë" etj. Sh. për këtë grup fjalësh sidomos Boisacq 213, Walde-Hofmann I 48, Ernout-Meillet 52, Vasmer REW III 171v. Sikundër shihet, fjala e shqipes afrohet në radhë të parë me fjalët greke e latine. Në këto rrethana është për të vënë re mendimi i disa dijetarëve, sidomos i Hirtit, që te gr. ἔγγελλος: lat. *anguilla* gjejnë një barazim proetnik, të datës indoeuropiane, sh. literaturën te Walde-Pokorny I 64. Në këtë çështje fjala e shqipes së bashku me ilir. Ἐγγελλᾶνες është vendimtare. Ajo flet për ekzistencën e një barazimi indoeuropian dialektor në kuptimin e A. Meilletsë, për një fjalë të kufizuar në greqishten, latinishten, ilirishten e shqipen. — Sh. edhe *njitë*.

(*ng at*) "pranë, në krah", ndajfolje e parafjalë. G. Meyeri 220 e bashkon me *qas* "afroj" *qasem* "afrohem", Kamarda I 323 me *ngas nget*, Weigandi (Balkan-Archiv I 254) trajtën *ngiet* të Veriut me *njes* "ngjit".

Fjalë e gegërishtes. S'e ka Buzuku, i cili përdor *afërë*, as toskërishtja, që ka *pranë*, e as arbërishtja e Italisë, që thotë *danzë* (Piana dei Greci, Sigeli). Del sëpari te Budi (DC 185a): *Për ngiat tyne tue shkuom*. Bardhi (Parathënia f. 2) *tue vum për ngiat tyne ende mbë giuhët të Latinjet; ani përngiat, o përfundit vuna arbënisht*, Prope *Ngiat* (Iuxta *Ndaj*, Proximus *Afërë*); ashtu edhe f. 199 *Ngiat* "Prope", 206 *Ngiat shtëp̃isë* "Prope domum", *Ngiat ujit* "Prope aquam". Bogdani (I 25, 26; 70, 3; II 47, 6) *Kÿ Yll i Merkurit gjithë herë ecën ngiat Diellit* "Questa Stella di Mercurio sempre camina col Sole"; *njana kundrë sjetërësë vum ngiat ma fort dukenë* "opposita iuxta se posita magis eluescunt"; *Mb̃i dy të tjerë lymënash së mbëdhejsh, qi i shkojnë për ngiat* "oltre due altri fiumi reali, che li passavano vicini". Në Shqipëri të mesme, me asimilim të rregullt të grupeve *ngi ngj*, thonë *njat*; kështu në një këngë dasme prej Tirane e Preze *I rash njat e i gdhina larg* (Sh. Sheshori, Visaret e Kombit XV 96). M. Hasluck (Alb. Reader 76) jep për Elbasan edhe kuptimin "ndaj, në krahasim me": *kjo e temja nuk është gjë hiç njat të dhanrrit Mretit* "This trick of mine is nothing compared to the Sultan's son-in-law's". E ka dhe Mitko 218 si *ngjatë* "afër, pranë". Trajta *njatë* te *Nuk bijem këtu njatë* e N. Frashërit (Qerbelaja 100) do të jetë një nga gezizmat e këtij poeti. Trajtën letrare të Veriut përdor përkundrazi Kristoforidhi (Psalm 22, 11): *Mos u largo prej meje : sepse shtrëngimi është ngjat*.

Etimologjikisht është një me *gjatë*. Kështu në Kosovë, ku *gjatë* shqiptohet *gatë gāt*, edhe *ngjat* thuhet *ngat*. Khs. prej këngësh popullore t'asaj ane *Ngat xhemit* (gjemit) *i ju kan afrue*; *Ni rek ngat ish kon çillue* (G. Elezović, Arhiv za arb. starinu I 56 varg 85, 57 varg 130, II 253). Në këtë kuptim

edhe *ngiat* e Bardhit e e Bogdanit tregon identitetin e fjalës me *gjatë*, e cila në geg. veriperëndimore shqiptohet *giatë*; Bogdani edhe këtu, në zbatim të parimit ortografik të tij, përdor trajtën e Shkodrës, jo të Kosovës. Prej gjuhës së tjera me shqipen afrohet këtu rumanishtja në *linga* "pranë, ngjat" nga lat. *longum*, sh. Puscariu EW 979. Prej italishtes khs. te Dante (*Inferno* X varg 53, Parajsja XXXII varg 130) *Un'ombra lungo questa infino al mento; Siede lung'h'esso, e lungo l'atro pose.* — Morfologjikisht *ngjat* është përngjitur me *n-*. Trajta *ngiet* e geg. veriore paraqitet me palatalizimin e *a-së* në një *e* të hapët në atë dialekt, për të cilin sh. Jokl LKU 187, Zbornik Belić 43v. e shënimet tona Li.Posn. VII 200. Varianti *nget*, si ndajfolje e si parafjalë te Lambertzi f. 135v, ka dalë nga ndrimi *je : e* i geg. veriore, Në gjuhën e sotme edhe primitivi *gjatë* ka hyrë në përdorim, si ndajfolje vendi me kuptimin "buzës, anës" e si ndajfolje kohe "sa kohë që zgjat, në kohën kur", *gjatë dimrit*. Është një përkthim (kalk) i it. *lungo*, me të dyja kuptimet.

ngjir "i marr zërin", *ngjirem* "më merret zëri". G. Meyeri 308 jep *qirr ngjirr, qirrem ngjirrem*, dhe lëkundet midis një afrimi me gr. *κέρκος* "thatë-sirë; ashpërsi, të qenët i ngjirur" e me angl. *hoarse* "i ngjirur". Etimologjisë së parë i mbahet Pedersen i KZ 36, 329, Boisacq 443 (fjalë onomatopeike), sh. dhe Walde-Pokorny I 414,327. Përkundrazia E. Hermann (KZ 41,47) dyshon në këto krahasime indoeuropiane për një fjalë onomatopeike siç është kjo e shqipes. Khs. dhe Ostir, Arhiv za arb. starinu II 296. Nëpër fjalorët etimologjikë krahasimtarë nuk del më asnjë nga dy barazimet e G. Meyerit.)

Fjalë e mbarë shqipes, e spjegueshme me mjetet e brendshme të gjuhës. Sikundër e pa dhe G. Meyeri, *gj-ja* te *ngjir ngjirem* është tingull sekundar, *ngjirem* është *nqirem*. Kjo nuk mund të ndahet nga *shqirem çirem* "bërtas sa më ngjiret zëri". Po sikundër *shqirem* shpie te *shqerr*, e *çirem* te *çjerr*, edhe *ngjirem nqirem* i përkasin verbit *shqerr*, e ndryshojnë nga *shqirem* vetëm në punë të prefiksit. Raporti morfologjik është i njëjti si te *ngarkoj : shkarkoj, ngul : shkul* etj., veçse kuptimi te *ngjirem* nuk është i përkundërt si te këto forma. Variantja *ngjirr ngjirrem* që sjell Kristoforidhi për të folët e Përmetit i detyrohet geminacionit ekspresiv të *-r-së*. Trajta *ngjurrem* e Beratit (po te Kristoforidhi) rrjedh nga një labializim i *i-së* në *y* e nga ndrimi i kësaj në *u*. Po *ngjër ngjërëm* e tosk. jugore mbetet e paqartë.

ngjok "godit" (?) G. Meyeri 192 jep prej dialektit të Siqelisë *ngjoku* "e goditi, i ra" dhe e afron këtë me *klokë* "kërrabë, çomagë"; sh. dhe Puscariu EW 719.

Është një nga ato fjalë që i ka të përbashkëta arbërishtja e Italisë me dialektet jugore të toskërishtes. Në Çamëri *ngjok* është "piskon, thumbon" (miza, bleta, arëza). Tase jep *rri e rri e më ngjokin ethet ngandonjëherë* për "më shtypin, më zënë, më ngasin". Në Gjirokastrë *u ngjoknë* "u përleshnë, u kacafytnë". Ashtu si *ngjirem* është *nqirem (shqerr)*, edhe *ngjok* është *nqok n-qok : qok* "çik, prek lehtë; kuk; rrok, kap dorën e tjetrit në shenjë përshëndetje": *qoke një herë*. Identitetin e *ngjok* e të *qok* e vërteton edhe kjo, që në Elbasan thonë *më qukin ethet kajherë* (M. Domi), e cila i përgjigjet shprehjes, *më ngjokin ethet* që dhamë më sipër. Formimi i ka dhënë verbit *ngjok* një kuptim intensiv. Afrimi me *klokë* nuk mund të mbahet, se *ngjok* nuk paraqitet me *gl* as në ato dialekte (çamërisht, Siqeli), të cilat ruajnë këtë grup konsonantesh. Me *-gj-* e ka fjalën dhe shqipja e Greqisë: aty hyn pas mendimit tonë dhe *gjokës njokës* (nga **ngjokës*) "djalli" te Reinholdi (f. 34), me kuptim të parë "ai që të kap" ose "ai që kapet me ty", khs. po në ato dialekte *rekës* "vigan" (G. Meyer 363), për ne prej *rrek* "lodh, mundoj, mër-

zit' rrekem "përpiqem, rropatem". Jo nga një *ndjokës*, prej *ndjek*, si mendon G. Meyeri, Alb. Studien V 97. — Prej geg. veriore hyn këtu *janë nrykë berret* (ose *delmet*) "janë ndërzye" (Gazulli), prej *ngjyke*, me kuptim të parë "janë kapë". Khs. për semantikën *u mbërthyen* "ἄρπαχτήκανε, u kapën- (kali me pelën), te Pedersen i f. 39, 156. Për ndrimin *o : y* khs. geg. *qyfte* për *qofte*, prej turq. *köfte*.

nofull f. "fulqi". G. Meyeri (f. 310 v.) kundërshton si spjegimin nga lat. *gena* "faqe" të Diez-it ashtu dhe atë nga gr. γνάθος "nofull" që kish dhënë Meyer-Lübke; ai mendon — me rezervë — për një afrim me it. *ganascia* ven. *ganasse* friul. *ganasse*, pra përsjat një burim prej latinishtes. Diefenbachu I 57 e pat shikuar si të afër me fjalën greke. Një kompozit *no-full* gjen aty Bariçi (Arhiv za arb. starinu I 150v.), duke afruar pjesën e parë me lat. *gena* "faqe" gr. γνάθος "nofull" etj. e të dytën me sllav. *čelustъ* "nofull". Treimeri (KZ 65, 114) e shpie te një bazë parashqiptare **nāpstā* dhe e krahason me ind. e vj. *snāpayati* "lan", krahasim që Jokli (IJ XXIV VII 217) e përcjell me të drejtë me një pikëpyetje.

Fjalë e mbarë shqipes, meqë përveç gegërishtes e ka Borshi (Breg i Detit) si *nofoll* (M. Totonj). Sikundër e kemi shënuar shkurt në *Revue de Linguistique* VII 1 197, nuk është gjë tjetër veçse *n-ofull* "në ofull", nga lat. *offula* "kafshatë e vogël", e cila nëpër dialektet italiane jugore ka dhënë kuptime të 'afra me të shqipes : napol. *gnoffçle* "nofull", në Apuli *nëffolo nëffçle* "bulçitë plot me ujë", për të cilat sh. Meyer-Lübke REW 6047. Këtë etimologji e kish përsjatur dhe G. Meyeri, po pa të drejtë e kish lënë mënjanë. Është një nga ato fjalë që janë përfutur brenda fjalisë, në shprehje si *shtie bukën n ofull*. Khs. *nije* te *ije* si dhe *nazil*, *nderr* : (terr), *nëndërr* etj. te Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 82v. — Shqipja përveç *nofullë-s* ka marrë prej latinishtes dhe një tjetër emër të kësaj pjese të fytirës : *fulqi fëlqinjë*.

nulë f. "gjyshe". Këtë fjalë që dëshmon Kristoforidhi për të folët e Beratit, Jokli (LKU 40) e spjegon nga lat. *anulla*, deminutiv i *anus* "plakë". E kundërshton Bariçi (Arhiv za arb. starinu II 413) e Treimeri (Slavia III 45), me arsyetim të se -*n*-ja do t'u kish rotacizuar në toskërishten.

Te Fronto sipas Ernout-Meillet 58 dëshmohet vetëm *anula*, që me *l*-nëvelare të saj nuk mund të ipte në shqipen *nulë*. Përveç kësaj as *anula* as *anus* vetë nuk rrojnë në gjuhët romane. Te *nulë* kemi një formë haplogjike të fjalës *nunëlë* "nunë; gjyshe nga ana e nënës", e cila s'është veçse një rrjedhojë e *nun*-it me *-lë* (sh. *nun*). Kështu edhe kjo fjalë nuk është huazim latin, po është rezultati i një zhvillimi të brendshëm të shqipes.

numër m.; *numëroj nëmëroj*. Pas G. Meyerit (f. 312, Alb. Studien IV 19) nga lat. *numerus*, *numerare*. Sh. edhe Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1050, Puscariu EW 1204.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku, si emëri i të pestit libër të Moit. seut: *Zgiedh librinë e Numërit* (LIIIa), huazim letrar nga lat. *Numerus*, it. *Numero*. G. Meyeri me të drejtë trajtën e emrit *nëmër* e gjen të formuar pas verbit *numëroj*, e m'anë tjetër atë të verbit *numëroj* pas emrit *numër*; pra ai me të drejtë refleksoi e lat. *numerare* e sheh të *nëmëroj*. Nga *nëmëroj* me metatezë e me shtim të një *-d*-je si tingull homorganik ka dalë tosk. jugore *mëndroj*. Ndërkaq shqipja prej latinishtes gjan të ketë marrë vetëm *nëmëroj* nga *numerare*, me gjithë se ekziston dhe fjala e vendit *njeh*, te Bardhi *Numerus Të njeFunë*, *Numerables Munë njeFunë*. Emri *numër* edhe sot nuk është i gjuhës popullore. Është fjalë librash, nga lat. (kishtare) *numerus* ose nga it. *numero*. Weigandi 63 si *numër* si *numëroj* i bie të ardhura prej italishtes.

Ky mendim për *numër* mund të jetë i drejtë, po për *numëroj* vlen mendimi i G. Meyerit.

nun m. "ai që mban foshnjen në pagëzim; ai që ndron kurorët o unazat e dhëndrit e të nuses; ai që i merr flokët fijanit (famullit) dhe e mban në krezimin"; sinonim i *kumbarë-s*; dhe "rrëfyes"; fem. *nunë*; *nunëlë* f. "nunë; gjyshe nga ana e nënës"; *nunëri* f. "kumbaria; gjithë nunët bashkë"; *nunë-rohem* "rrëfehëm (në kishë); bëhem nunë, bëjmë nunëri me një"; *nunós* "marr tjetrin në rrëfim" (si prift), *nunosem* "rrëfehëm në kishë". Mendimet për burimin e kësaj fjale janë të ndara. Pas G. Meyerit 312 (sh. dhe Ngri. Studien III 48) vjen prej gr. së re *νοῦνός* e kjo prej latinishtes. Pokështu Weigandi 63. Përkundrazi Puscariu (Z. f. rom. Phil. XXVII 744 v., EW 1207) rum. *nun* fem. *nuna* "kumbarë në një kurorë" bashkë me shq. *nun*, me gr. e re *νοῦνός*, it. e vj. *nonno* "nun" *nonna* "nunë", sard. *nonnu* "nun" etj. i spiegon drejtpërdrejt nga lat. *nonnus*. I këtij mendimi është dhe M. L. Wagner, Das ländliche Leben Sardinien im Spiegel der Sprache 159. Edhe Skoku (Revue d. ét. slaves X 197v.), duke ndjekur përhapjen e fjalës përveç se në shqipen, rumanishten e greqishten e re edhe në bullgarishten e në dialektet serbokroate, e shpie atë të latinishtja ballkanike. Sh. sëfundi dhe Alessio (Annali d. Fac. di Lettere e Filos. Bari I 35), Papahagi 789. Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I² 1046) sheh të *nun* refleksin e sic. *nunna* "babë", po jo më në Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 5. Për format e greqishtes së Italisë jugore (*nunno*, *nunnu*, *nunna* etj.) sh. Rohlf's EW 1468.

Del sëpari të Budi, e vetëm për "rrëfyes, confessor", kurse për "kumbarë (në pagëzim e në kurorë) ai ka *kumëtrë* "kumtër": *kur nier̄ s do ma u rrëfyem nunit vet* (SC 3, edhe 4, 238, 288); Bardhi ka Confessor *Rrëfyes*. Buzuku nuk ka as njërën as tjetrën, rrëfyesi nuk del në vepër të tij. Kuptimi "gjysh, gjyshe" që ka fjala në disa gjuhë romane, sidomos në italishten e dialektet e saj, del dhe në shqipen, të *nunëlë*, me shkurtim *nulë* (sh. këtë fjalë). Në shqipen *nun* ka konkuruar me *kumtër* e me *kumbarë*, e para huazim latin, e dyta element latin hyrë nëpërmes të greqishtes bizantine. *nun* është një nga ato fjalë të shqipes, për të cilat mbetet e dyshimtë rruga e shtektimit, a drejtpërdrejt prej latinishtes në shqipen e rumanishten, apo edhe kjo nëpërmjet të greqishtes, me anë të kishës bizantine; sh. për të tilla fjalë Revue de Linguistique VII 1 184vv. Për Bizantin si vatër rrezatimi fjalësh latine në gjuhët ballkanike flet Skoku, Byzantion VI 371 vv.

nxit "shtyj, ngacmoj, nguc"; *nxit* m. "shpejtësi; *nxitje* f. "të nxiturit"; *nxitōj* "shpejtoj, eci a punoj me nxit, me të shpejtë", *nxitohem* "ngutem"; *nxitim* m. G. Meyerit 302, duke e bashkuar fjalën me një *ndit* "shpejtësi" e me *tërndit* për "trondit" që ai e merr si *tëx-ndit*, nisët për *nxit* nga një bazë *zdit*, ashtu si për *naxjerr* nga *zdxjerr*, e këtë *dit* si *di-t* e krahason me ind. e vj. *diyati* "nxiton" gr. *διεσθαί* "me nxitue, me ikë", irl. e vj. *dian* "shpejt". Kjo etimologji nuk ka zënë vend në fjalorët krahasimtarë të gjuhëve indo-europiane. Jokli (Mélanges Pedersen 150v.) jep prej burimesh më të reja (Jungku, Bashkimi, Weigandi) edhe variantet *nxis xis* e *zis*; ai me të drejtë bashkon me *nxit* dhe këtë trajtën e fundit (*zis zit*), të cilën G. Meyerit më një tjetër vend (f. 485) e spiegon — me dyshim — nga sllavishtja, serbokr. *zátka* "provokim". Te *nxis* Jokli sheh një verb të formuar nga participi më -t-, pra refleksin e një baze **en-dog'itiō*, duke e afruar atë përbrenda shqipes me *nxeh* e me *ndez*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (XLIXv., Postcommunio) ashtu na ban me të *nxitunë* të *pāpushim*, na asaj *jete* me *ardhunë* "sic tendere congruenter, ut at eam pervenire possimus". Budi (p.sh. DC 194a, 219a, 220a, SC 20, 50, 175, 230) *Po mēn̄nē e nxiti*; *Kush më nxiti me i marrë*; *ō për të mpsuomit e të nxitu-*

nit e tjerëve; aty ashtë mā moti e koha me nxitunë ndë vetëhe një të madh dëshir e ū të shpirtit; sikur zjarrë me sã drū e thëngjinj tue e nxitunë. Bardhi (f. 3 e Parathënies) . . . *dj kafshë . . . më shtynë, e më nxitnë me u fëdignë, Stimulare Me nxitunë, Stimulus Të nxitim, Stimulatio Të nxitunitë.* — Si u tha dhe më lart (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Ser. Shk. Shoq. 1, 1961, 70v.), *nxit nxis nxitoj nxitim, bashkë me zis zita, nuk ka lidhje as me tërëndit trondit as me nxehtë nxehtë e ndez, sepse nga forma shihet se është tjetër fjalë. Lidhet në radhë të parë me sinonimin e saj *cys cyta* "ngas, ngaemoj, shtyj", duke dalë *nxit* si një kompozit me preverbin *n-* nga *en-*. Kështu *nxit nxis* nga *n-zit n-zis*, e *cys cyt* nga *t-sys t-syt*. Kompozite të *zit zis* me preverbin *gë-* janë *gëcit* "tundoj" *guxit guzit* "ngas, gërgas" e *gaxhis* "bëj shaka", me metatezë (te N. Frashëri etj.) *xëgit* "shpoj, ngas (një njeri)", për të cilat sh. te *gaxhis*. Ndërkaq pranë *cys* ka edhe *cus*, pra ka forma me *i*, *u* e *y*. Çështja e etimologjisë së fjalës mbetet ndërkaq e hapët. Ndër variantet e saj do gjetur cila është forma bazë, ajo me *-i-*, ajo me *-y-* apo ajo me *-u-*; e për nga konsonanti ajo më *s-* apo ajo më *z-*.*

nytëro "murmuroj, ankohe". E ka Bardhi: Susurrare *Me u nëkuem, me nytëruem*, f. 223 *gjë t i emendonjë pã nytërimë, e pã zã*. E paspieguar te G. Meyeri 313. Si duket, fjala onomatopeike.

Nj.

niegull f. "mjegull". Del që te Bazuku, si *niegull*, p.sh. (LVII/2 = LXVII/2, Ozea 6, 4) *Mishërierja juoj të jetë porsi niegulla e ndënatësë* "Misericordia vestra quasi nubes matutina". Edhe Budi (DC 26) e *të mbuluom me një niegullë të zezë* (dhe f. 211); Bardhi *Nebula Niegulla*. Pas mendimit të përgjithshëm vjen, bashkë me rum. *negura* "mjegull", nga lat. *nebula*, qoftë nga një bazë **negula* **negla*, qoftë nga *nebula* përzier me *niger* "i zi". khs. G. Meyer 283v., Puscariu EW 1168, Jokl Studien 57, Weigand 56, Meyer-Lübke REW 5865.

Në geg. lindore, me degëzime edhe në Veri e në Shqipëri të mesme (Mat. Polis i Elbasanit, Dumbërë), vihet re asimilimi i grupit *mj* në *nj*: *njaft*: *njaft*, *mjedër*: *njedër*, *mjera*: *njera*, *me mjekue*: *me njekue*, prandaj në Dibër si reacion *mjerka* për *njerka* (sh. *njerkë*). Për Dibër A. Imami (Ed. e Re I 106 v.) jep *njaft* për *mjaft*. Edhe Kristoforidhi (Gjaja e Malsorit Kop. letrar I 11) përdor trajtën *njegull*. Kështu kjo fjalë nuk është vetse një variante dialektore e *mjegullë*-s. Asimilimi *mj*: *nj* fonetikisht ka shkuar nëpër shkallën *ni*. Kjo shkallë e ndërnyjeme *ningullë* ruhet tek autorët e vjetër të Veriut. Këta e shkruajnë *niegullë*, poashtu si kanë *nieri* për të sotmen *njeri* të pjesës më të madhe të shqipes, sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1 (1958) 43v. Në këto rrethana nuk ka vend për një burim të kësaj fjale nga latinishtja. Atëherë rum. *negura* e ka bazën te kjo fjalë dialektore e shqipes, duke ndikuar mbase më të dhe lat. *nebula*. Në rumanishten ka gjurmë fjalësh e trajtash të një gegërishtje të vjetër, sh. Studii si Cerc. lingvistică X 4 (1959) 530v., Rev. shkenc. e Inst. pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës 1 (1964) 23, Zeitschr. f. Balkanologie II.

njerkë f. Nga lat. *noverca*, G. Meyer 313, Puscariu EW 1199, Weigand 64, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1043 e REW 5970.

Fjalë e mbarë gjuhës. Refleksi i parë i saj është *njerkë*, ashtu si na del te Bardhi: *Noverca Njerka*. Kjo *ni* u zhvillua pastaj rregullisht në nazalin palatal *nj*, ashtu si te *njeri* etj., sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser. Shk. Shoq. 1 (1958) 43v. Trajta *mjerkë* e Dibërës është hiperkorrekte; meqë në atë dialekt *mj* u ka asimiluar në *nj* (*mjegull*: *njegull*), te *mjerkë* ngjan e kundër-

ta, me anë të një lloj reacioni.) Historikisht *njerkë* është një nga ato huazime latine të shqipës që nuk ruhen në gjuhët romane, me përjashtim të aromunishtes: *nuearca* *ñarca*, mashk. *niereu* "njerku". Ndërkaq së paku trajta mashkullore e fjalës aromune afrohet aq fort me shq. *njerk-u*, sa nuk ka si mos të jetë një huazim i kësaj. Për këtë trajtë të shqipës është tepër, edhe e padrejtë, të rindërtojmë një bazë latine **novercus*, e padëshmuar gjëkund. Është një formim analogjik pas *njerkë-s*. Për *njerkun* shqipja ka një tjetër huazim latin, *vitërk vitruk* nga *vitricus*, sh. këtë fjalë.

njicë f. "rrjetë e madhe për peshk, që lëshohet pingul në ujë". Fjalë e geg. veriore; mungon te G. Meyeri, e ka Junggu me Bashkimin, me shënimin e përgjithshëm "lloj rrjete". Një përshkrim më i shtjelluar te I. Ndojaj Bul. Teknik I Nr. 2 (1943) 183v., ku flitet për *njica gjûcash* (me syza shumë të shpeshta), *njica të shpeshta* (për qefull) e *njica të rralla* (për krap): "peshku tue u ulun teposhtë, sidomos kur bjen Drini, shkon e mbetë ndër syza të tyne në mënyrë qi s'mundet kurrsesi m'u lirue". Khs. me këtë përshkrim dhe atë që gjindet te N. Filip—N. Rraka BSN 1 (1957) 136. Nga mënyra si gjuhët peshku, nga puna si *njit* = si ngel në syzat e rrjetës, pra nga *njis njit* "ngjit", ka dalë dhe emërtimi i saj; sh. BUST 1 (1962) 224, VII Congr. Internaz. di Scienze Onomastiche Firenze-Pisa 1961 f. 249. Reflektimi i *ngj-së* me *nj-* e cilëson *njicë-n* si fjalë të gegërishtes; *-cë* nga *-të*, *-të*, pra baza idealisht një *ngjitzë ngjitsë*. Etimologjikisht një me *njicë* është *lule njica* "Viscaria viscosa" e geg. jugore, të cilën Weigandi (Balkan-Archiv II 223) me të drejtë e lidh me *njitëse njitësinë*. Edhe kjo bimë e ka emrin nga të ngjiturit.

njilë f. "Tinka vulgaris, lloj peshku i gjinisë së krepve". Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri, e jep sëpari Junggu si "sorta di pesciolino", e Bashkimi si "sorta di pesce delle acque dolci". Zgjerim me *-acë njilacë* "njilë e vogël me dimensione" (I. Ndoja, Bul. Teknik I Nr. 2, 1943, f. 176). Pas gjase refleksi i një më të vjetre *ngjilë*. Kësaj formalisht do t'i mjaftonte it. ose lat. *anguilla*. Po ndryshimi i kuptimit është tepër i madh; njila me trupin e saj trashaluk nuk përngjan aspak me ngjalën.

n ollë f. Për këtë fjalë, që s'e ka G. Meyeri, Jokli (Studien 65v.), në mbështetje të faktit që *nj* rrjedh disa herë prej *ngj*, mendon — me rezervë — për një afrim me gjerm. e lartë të vj. *salò* "i mbyllët, i turbull, i ndytë", ags. *salò* "i mbyllët", irl. *salach* "i ndytë" etj.; baza e fjalës shqipe sipas tij një **n-sāl-v-* me ndrim *lv* në *ll* (velare). Në kundërshtim me këtë Vasmeri (Studien I 47) nisat nga "shenjë" si kuptim i parë, dhe e lidh kështu fjalën brenda shqipës me *njom*, duke krahasuar për kuptimin sllav. *znakъ* "shenjë": *znati* "me ditë". Sh. dhe Ostir, Arhiv za arb. starinu II 296. Mendimin e Joklit nga fjalorët krahasimtarë e pranon — me një farë rezerve — vetëm Walde-Pokorny II 454, si dhe Bariçi Arhiv za arb. starinu II 85.

Fjalë dialektore (pas Kristoforidhit e Shqipërisë së mesme) që është bërë e mbarë gjuhës. Neologjizma janë *nfolloj nfollos*. Është edhe kjo një nga ato fjalët e fondit të trashëguar, po që kanë dalë nëpër zhvillimin e brendshëm të gjuhës. Pranë *njollë* ka *ngjollë*, e pranë *ngjollë* edhe *ngjyllë*, të dyja te Godini (f. 145, 249 te *Fleck, Mat*). Shihet se *ngjyllë* ka dalë nga *ngjyey* si një postverbal më *-llë*, si *çallë* "çallatë" nga *çaj*, sh. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 67. Ndërsa *ngjyllë* ruan vokalizmin e verbit, vetëm duke reduktuar *-ye-n* e *ngjyey* në *y*, *ngjollë njollë* qëndrojnë ndaj atyre në lidhje apofonie, posшту si *plaje* ndaj *plyrem plyej përlyej*, khs. edhe *borë*: *bie*, *Vorë*: *vier vier*. Pra *ngjollë njollë* paraqet një formë aoristi ose participi të moçëm më *-o-*, sh. *njom*. *njollë* nga *ngjollë* me asimilimin *ngj*: *nj* të gegërishtes; në këtë dialekt edhe *ngjyey* ka përfunduar në *njyey*. Për kuptimin do thënë se njolla emërtohet shpeshherë prej së ngjyerit a së lyerit: gr. *ἀναχρώννυμι* "ngjyey"

e "ndyj, infektoj"; nga gjuhët romane logudor. (sardisht) *tintieddu* "njollë e zezë në drithë prej ndryshkut të tij" nga *tingere* + *nigellus* (Meyer-Lübke REW 8750). Prej shqipes vetë khs. *lye* "macula" te Bogdani (I 64, 6): *lyej*, sh. *lyth*.

njom "lag pak, rij; vadit" (arën); *njom gojën* "lag gojën me një pemë"; figurshëm i *njom dorën* "i jap lëmoshë"; edhe *ngjom*; i *njomë*, i *ngjomë* "pak i lagët, i ritë; i gjelbër, i freskët, jo i thatë": *bar i njomë*; *dru e njomë*; *gry-njëra të njoma*; *qepë të njoma*; *djathtë i njomë*; *mish i njomë*; "i ri; delikat": *mosha e njomë*; *fëmijë e njomë*. G. Meyeri 314 nuk e spiegon, vetëm shënon se *nj-ja* duket të tregojë që fjala më parë në vend të *o-së* ka pasur një *e*. Jokli (Studien 66) niset nga trajta *nglomë* që jep Kristoforidhi (f. 264) për çamërishten, dhe kështu e afron fjalën me grupin sillav të rus. *гленъ* "lagështi, lëng", slloven. *glen* "pështymë, baltë", gr. *γλοιός* "vaj i ndytë, lëng ngjites" etj. Etimologji e pranuar te Walde-Pokorny I 617, Walde-Hofmann I 617, Pokorny I 361.

Fjala e mbarë gjuhës. Te Budi (SC 245, 392) *posikundrëse plaga e korpit e ndësë ashtë njomë; me bër e me gjeth të njomë*. Bardhi Tener, *molle I njomë*. Bogdani (I 36, 15; 37,20; 122,17; II 48,9; 118,5) *Mbī dhēt anshtë Elementi Ujit, i silli anshtë i stofëtë, e i njomë* "Sopra la terra vi è l'Elemento dell'Acqua: questa è di qualità frigida, et humida"; *të njomëtë* "humido"; *possi një trisallë, ndo si një prutekë e njomë n dheut së thāti* "sicut virgultum, come una bacchetta tenera de terra sitienti"; *burrit vet, qi doiq i njomë* "suo Marito, mortoli giovinetto"; *e mbë një nierī aqa të njomë si kje Krishiti* "et in persona tanto delicata, come era Christo". Lambertzi (Alb. Märchen 108) *Edhe fmiija e njom i bite nesh me djep. Nga rrjedhojat e fjalës, njomësi* f. ka marrë kuptimin abstrakt "të qenët i njomë", po në gjuhën popullore (si në Arapaj të Durrësit) shënon njomshtinat që ha bagëti; *njomëz* f. "filiz", në gjuhën poetike (letrare e popullore) edhe për një të ri a të re, qysh te Buzuku (XI/2, Psalin 127,3) *Djelmtë e tū porsi njomëzatë (ose -s-) qi qet ullinī përqark veti* "Filii tui sicut novellae olivarum"; sot në Veri *njome* f. (me *-e-në* e mocionit), fjalë përkëdhelëse kur u drejtohen fëmijëve të vegjël; *njomësirë njomësinë* f.; *njomsh* m. "bar i njomë"; *njomështinë*, pl. *njomështina* f. "gjelbërim, barishtë të njoma". Gazulli jep për Malsi të Madhe edhe me *njomtue* "me dhanë lëmoshë", *njomtoe fukarân* "njomja dorën". Për dialektet e Greqisë Reinholdi 28 e jep fjalën me kuptimin e "lag", gr. e re *βρέχω*, gjerm. "benetze", iu *njom kola* (për gola) "*εμιλάκωσεν*". Sotirios (Laographia I 83v.) jep prej ishullit Specia *Thashë, tātëzo, martomë, Kur të datë bar të njomë*, prej Markopulo (I 91, II 109) *vljastar të njomë, e çë vështron pajzënë të njomë?* Prej Kalabrie sjell Kamarda (II 114) *E më e bardha më e njoma, Ajo plakut i takkoi*, prej Siqelie (II 172) *Se xëkurin dhe njom zjarri i gjallë, me kuptimin "zbut"*. Dara ka *Pse ki kräh nani i njom* "Perchè questo braccio or fiacco". Në Piana dei Greci i *njomur* është "epileptik", quajtur kështu prej djesës o prej të zbuturit kur i bje njeriut ajo e tokës. Nga këto të gjitha si kuptim i mirëfilltë i fjalës del "lag, i lagët".

Për etimologjinë do thënë se si kudo, edhe në Çamëri fjala është *njomë*, *nglomë* që jep Kristoforidhi për atë dialekt nuk ekziston; edhe në Piana dei Greci të Siqelisë, ligjërim që ruan grupet *gl kl*, fjala, sikundër u tha, thuhet i *njomur*. Prandaj, si kemi thënë edhe gjatë (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1, 1958, f. 61v.), burimi i kësaj fjale qëndron më një vend tjetër. *njomë ngjomë* nuk mund të ndahen nga *ngjymë* f. "bojë, ngjyrë", po kjo nuk është veçse postverbal me *-më* i *ngjyeyj*, poashtu si p.sh. *ftomë* nga *floh*, *pështymë* nga *pështyjj*, *frymë* nga *fryjj*. Nga *ngjymë* ndryshon *ngjomë* në punë të vokalit, poashtu si *ngjollë njollë* nga *ngjyllë*, si *ploje* nga *plyej pëlyej*

që u zunë ngoje te *njollë*. Format më -o- reflektojnë me këtë vokal në thelb bazën me e indoeuropiane të gjatë, prandaj qëndrojnë në lidhje të një apofonie kuantitative ndaj atyre me -ye-, produkt diftongimi të një e-je të mirëfilltë. Nga *ngjomë* te *njomë* u arrit me asimilimin e grupit *ngj* në *nj*. Zhvillimi kuptimor ka shkuar nga *ngjyjej* "fut gishtin e kafshatën brenda në një lëng" në "lag" e nga "i lagët" në kuptimet e tjera që ka i *njomë*. Kështu i *njomë* e i *lashtë* kanë dalë prej të njëjtit kuptim të së lagëtit, veçse pastaj kanë marrë domethënie të ndryshme, bile të përkundërta, njëra "i moçëm", tjetra "i ri". Morfologjikisht forma primare e fjalës është (i) *ngjomë*, (i) *njomë*, particip më -më e i adjektivuar i *ngjyjej*. Verbi *njom* është sekundar, formë e dalë prej (i) *njomë*. Është një nga ato prezente që kanë dalë prej participit, si *shtir*.

R é s u m é

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XV

N

ndal "arrêter", ndalem "s'arrêter", ndalój "empêcher; arrêter", ndalë f. "arrêt, repos", dale! "laisse", kadál dalngadál. Pas un emprunt au sl. dalja "distance", mais un mot des sources autochtones, apparenté au groupe celtique cymr. dal dala daly "tenir" corn. dalchen "a taking hold of", etc., une concordance celto-albanaise. Premier sens du mot albanais: "tenir".

ndër m. , f. "honneur, considération; cours, valeur des monnaies", nderój "honorer, estimer, i ndershëm "honorable, honnête, probe; honoré". Ni du substantif latin honōrem, ni du verbe honorare. Mot albanais, dont le sens originaire est "visage", vue", et la base à peu près *andár. — Comme tel le mot résulte être apparenté à andër ëndër "rêve" en tant que "vue, vision", mot qui est du groupe du gr. ὄναρ ὄνειρος et de l'arm. anurj "rêve".

ndërkáq "entre-temps; cependant, toutefois", chez Gj. Buzuku ndëkaqë e përkaqë. De ces deux formes, la première est un calque de l'it. intanto, la deuxième de pertanto, tous deux mots savants. L'actuel ndërkajq représente une variation récente de ndëkaqë, avec remplacement de la préposition ndë par ndër.

ndërlíq "confondre les fils," provient, comme l'a bien remarqué Kristoforidhi, de liq-të "les lisses." A ce même groupe appartient ndërlíkoj "compliquer" ndërlíkím m. "complication", provenant de la forme ndërlík.

ndërmëtes m. "intermédiaire", de ndërmjët "au milieu (de), parmi" (G. Meyer). Une variation, pourvue de l'article préposé, est indërmjëts, qui comme telle n'a rien à faire avec l'it. intemezzo.

ndërsá "andis que", au sens temporel ("pendant le temps que"), et adver, satif ("au lieu de"). Attesté, comme ndësá, déjà chez P. Budi, est, peut-être comme ndëkaq ndërkajq, un mot savant, formé à l'intérieur de la phrase, de ndë ndër et sa. La forme mëså est une juxtaposition de la préposition më et de sa.

ndërtóí, dërtój "préparer; construire", ndërtesë f. "construction, édifice". Ni d'un lat. *directare, nulle part attesté, ni identique à drejtój "diriger", de drejt "droit". Probablement le même mot que trajtoj, employé au sens de "parare" dans l'ancienne littérature, où ndërtoj est tout à fait inconnu.

ndërrój, ndroj "changer, échanger" ndërohem ndrohem "se changer, c.à.d. de vêtements", ndërrím ndrim m. "changement, échange", ndërrësa ndresa fpl. "linge", ndryshe "autrement." Non d'un lat. *anterare (pour alterare) et *alterūsus, mais le proche parent de l'anc. ind. antara- got. anPar lit. antras "autre".

ndëshkój "punir, châtier", ndëshkim m. "punition, châtiment", dans l'ancienne littérature "inculpere, arguere, monere, obiurgare, reprehendere".

Du lat. castigare, passé aussi en allemand. De l'it. castigare provient kastigój. ndiç "donc". Mot issu d'une phrase, comme ndorrina, shklata et tant d'autres, une lexicalisation de në diç "si tu sais." De la forme në dish provient à son tour ndish de P. Budi.

ndiej "sentir, ressentir, remarquer, s'apercevoir, entendre". Ni le rapprochement avec gjegem "entendre, ouïr", ni celui avec di "savoir" ne sont satisfaisants. Comme *n-ticnj, le reflet d'une base préalbanaise *en-tegnjō, ce mot est probablement du groupe de lat. tongere "nosse, scire" tongitio "notio", osq. tanginom "sententiam" got. Pangkjan "βουλεύεσθαι, λογίζεσθαι". Comme en gothique à Pangkjan correspond Pungkjan "δοκεῖν, φαίνεσθαι", aussi bien en albanais à ndiej répond le passif më ndihet qui signifie "il me semble, il me paraît".

ndih ndif "aider, assister", ndihmë f. "secours, aide", ndihmës m. "aide, auxiliaire", ndihmës- "aide --". Le rapprochement au groupe de got. Peikan "prosperer, réussir" lit. tenkū "se contenter", vieux irl. tocad "bonheur, prospérité" a été mis en doute par G. Meyer lui-même, son auteur, tandis que I. Scheftelowitz le compare à l'av. dāy "j'ai soin". Issu probablement de "apparaître, se montrer" comme premier sens, le mot albanais semble appartenir à la racine indo-eur. *deik'- *dik'- "montrer", dans l'anc. ind. disāti "il montre", gr. δείκνυμι, lat. indico, -are, all. zeigen, etc., ndih à peu près d'un *en-dik'-skō. Dès lors, le lat. Di indigetes, désignation des dieux nationaux, resté obscure à tout ce jour, semble signifier au singulier indiges "celui qui aide", avec un sens qui conserve le mot albanais.

ndihet (më), më ndjetë "il me semble, il me paraît". Mot de la langue commune, qui apparaît dans les anciens textes, dans l'albanais de Grèce et d'Italie, comme aussi dans divers dialectes d'Albanie. Le proche parent de ndiej, v. ci-dessus.

ndodh, ndodhem "se trouver, être par hasard dans un endroit", i ndodhur "serviable", ndodhi f. "événement." Le rapprochement alternatif avec le gr. τεταγών "qui prend, qui saisit" et le lat. tango "toucher", ou avec le got. tēkan "toucher", n'a pas été généralement admis. Le mot albanais se rattache au gr. τεύχω "fabriquer, façonner; apprêter (un repas); produire" τυγχάνω "atteindre; rencontrer par hasard; réussir; obtenir", intrans. "se trouver par hasard", all. est taugt "il vaut, il peut servir" tüchtig "habile, capable", irl. dual "bon à quelque chose, convenable". La base de ndodh, *n-todh *en-todh remontant présumablement à un antérieur *tēgh -, cette forme se trouve être en rapport d'apophonie quantitative avec τεύχω et τεύξομαι, le futur de τυγχάνω.

ndormë (i) "azyme, sans levain", kulaç i ndormë, bukë e ndorme. Étant donné un sens plus général "ordinaire, commun", ce mot résulte être un dérivé adjectival de dorë "main", le pain fait sans levain étant le pain ordinaire et le plus facile à boulanger. Cfr. pour le sens le gr. εἰχερός "maniable, facile" δυσχερός "difficile" (χείρ "main"), εἰμορός "facile à manier" (μάρῃ "main"), lat. manualis manuaris "que la main peut tenir; manuel, maniable", all. handlich "maniable, commode", etc. Il existe, en effet, à côté de i ndormë, un i ndormtë "commun, usuel".

ndorrina "nonobstant, en dépit de", en albanais de Calabre. Mot issu d'une phrase, de ndo rri "bien que tu es assis", avec élargissement du verbe par le formant fréquent -na, comme dans andejna, pastajna.

ndrydh "disloquer, déboîter; opprimer; pétrir (le pain)". Le report de ce mot à un lat. *intrūdo, et de shtrydh "presser, serrer" à un *extrūdo, bases inexistantes, est à rejeter. ndrydh ayant à son côté me ndrithë avec le même sens, provient probablement d'une forme à -i- de dredh "tordre". Le préverbe indiqe un verbe factitif-causatif, au sens de "faire tourner".

ndryqem "se dégoûder", shtriq "étendre les bras, les jambes" shtryqem shtriqem "s'étirer". Non d'un lat. *intuberculare reconstruit, ni le parent d'alb. dru "bois", lat. durus etc., mais la forme réfléchie de ndreq "redresant à savoir ndreqem et ndriqem.

ndryshk m. "rouille", ndryshk "rouiller" ndryshkem "se rouiller". Non d'un lat. imaginaire *inrussico, de russus "rouge", mais avec fruth "rougeole", le reflet d'un indo-eur. *drudh-, élargi par le suffixe -shk, se rapprochant ainsi du lat. ruber (et russus), gr. ἔρυσθος, lit. raudas, all. rot "rouge", etc. Pour ndryshk "rouille des céréales" cfr. lat. robigo, all. Rost, frç. rouille, it. ruggine (del grano), etc.

nduk "tirer; pincer; plumer (un oiseau)". Comme l'a bien vu G. Meyer, à rapprocher de lat. dūcō "tirer à soi; conduire, mener", got. tiuhan all. ziehen "tirer", etc. A retenir le postverbal ndukë f. "toison". Le verbe albanais remonte à une base à voyelle interne courte; quant au préverbe n- renonçant à en-, il est comparable au lat. indūco.

ndulket "devenir blé", dit des fruits, aussi ndyket, ndujket, nduget, etc.; i ndulkët, i ndylkur etc. "blé". Plutôt qu'à un lat. *dulculus non attesté, dérivé de dulcis, ce mot remonte à un *ntulk, se rattachant ainsi à tul "chaire sans les os, mie de pain".

ne "chez, à, vers", aussi nek, nekë, comme le synonyme te à côté de tek. Forme issue d'une contamination de te et de në "dans".

nesër "demain", i nesërm "de demain", e nesërmja f. "le lendemain; l'avenir", pasnesër "après-demain". Ni du groupe de l'osq. nēsimo "le plus proche" vieux irl. nessa "plus près", got. nēhva "près", etc. (G. Meyer), ni d'un antérieur *nati-herë représentant un *noktio, en supposant un passage sémantique de "matin" à "demain" (H. Pedersen), ni d'un *n-esër: gr. ἔσς ἡός lit. ausrà "aurore" (H. Barić), ni d'un *(e)n ōk'u "bientôt, prochainement" (M. Vasmer). nesër plutôt de n esëll herë "à jeun", nesëret "le lendemain" de n esëll heret.

nëse "si, dans le cas que". D'une juxtaposition de në se, à l'intérieur de la phrase. Chez Gj. Buzuku se në, avec ordre inverse des parts, E se ajo në u harotë "Et si illa oblita fuerit".

ngalem "ne pouvant pas marcher, être retenu, empêché", ngel "rester", ngalój ngalohem "être empêché des jambes", ngalakáq "lent, lourd". Ni de l'it. incagliare, ni d'un lat. *incalleare, de callis, ni le proche parent de gul "sans cornes". Des deux formes du verbe, ngal et ngel, la première est la primaire, la deuxième est issue d'elle par métaphonie. Apparenté au lat callum, sl kalit?

ngallmój "clouer, importuner, exciter, taquiner" shkallmój "déclouer, écraser". Ni de l'it. incalmare "griffer", ni d'un lat. *incalamare (G. Meyer), ni apparenté à akuill "glace", sl. ecclésiastique kaliti "recuire, tremper" serbo-cr. prikala "gelée" (N. Jokl). Avec ngallón "montrer l'épi" (du grain) te ngallis "pousser; exciter, importuner" notre verbe se rattache à kall kallí-u "épi". A confronter pour le sens le vieux sl. klasr "épi" qu'on considère, apparenté à kolo kolti "piquer".

ngallón "montrer l'épi" (du grain), ngallë f. "taille des boulangers, tige de l'oignon", ngallim m. "jet, pousse", ngallis ngallita "pousser; exciter, importuner", ngallinë f. "escrescenza di porro sulla pelle degli animali, o scorza dei vegetali". Toutes formes dérivées de kall kallí-u m. "épi". V. ci-dessous ngullón.

ngarë d "courir". Verbe composé de ngas rend, un "verbe délocutif" dans le sens de M.E. Benveniste, comme bzāj "appeler", vrej "remarquer, observer", etc. Chez F. Blanchus (1635) encore me ngām rend "currere", ohez P. Bogdani nget rend Dielli "corre il sole".

ngastër f. "morceau d'un gâteau; district, région; quartier", n'appartient pas à ngas "toucher; irriter". C'est bien de néo-gr. γάστρα "pot à fleurs", passé à travers les significations "pot cassé", "morceau d'un pot cassé, test, tesson", au fond le même mot que gastare "verre".

ngatërrój "embrouiller, entortiller, confondre" shkatërrój "ravager, détruire, dévaster; débrouiller, démêler". Ni le proche parent de ngathem "s'engourdir" et de l'it. dialectal ingattiar "embrouiller" (G. Meyer), ni dérivant de l'it. scatarrare "jeter dehors" (R. Helbig), ni remontant à des bases latines inexistantes *inquaternare *exquaternare (L. Spitzer), ni à rattacher à shiie "verser, répandre, lancer," mbëshjtjell "envelopper" shtij "étendre" et en outre au lat. sterno "étendre, coucher à terre". Des deux verbes, shkatërrój est un dérivé de katër "quatre", sens propre "partager en quatre pièces", dit originellement du bétail tué. De shkatërrój on a créé ngatërrój par analogie, d'après ngarkój shkarkój, ngul shkul, etc.

ngërmój "irriter, exciter, importuner; pousser à" n'a rien à faire avec l'it. angheria "oppression, tyrannie", mais — comme l'avait déjà deviné Kristoforidhi — est au fond le même mot que gërmoj "fouiller", cfr. des expressions comme mos e gërmo më atë punë "laisse la chose où elle en est", mot à mot "ne pousse plus cette chose" ("ne la fouille plus").

ngërthëj "engrener; contracter (les sourcils)", dans le dialecte de Mirdita (Gazulli) me ngërdhÿe "entortiller", est du groupe de gardhë "emboîture" gardhën "jable", gardhnojçë "fraise", tout mots dérivés de gardh "haie, clôture", où rentre en outre le nom du village Zgërdhësh.

ngos "rassasier", n'a rien à faire avec son synonyme ngop. Mot provenant du néo-grec, plutôt de ἀγκώνω "enfler, gonfler" que de ἄγκω "serrer la gorge, étrangler".

ngrys "obscurcir", ngryset ngriset "il se fait tard, le jour baisse". Pas à rattacher au lat. creper "obscur" crepusculum, mais plutôt au groupe de l'anc. indien krsná- "noir, obscur", vieux sl. сѣнь "noir", etc. ngrys forme à labialisation de l'i en y. Dans ce même groupe rentre peut-être, en outre le nom du fleuve Κρίσος de la Dacie, pour lequel M. Vl. Georgiev, sur le témoignage du nom actuel Crisul Negru, postule "noir" comme premier sens.

ngujój "enfermer, clore, bloquer". Un dénominatif de kunj "coin" formé à l'intérieur de la langue, d'un *nkujonj. Est à écarter l'idée d'une base latine *incunearé reconstruite, problématique tout aussi pour le roum. încuia "fermer", qui peut être issu à son tour de cuiu "coin".

ngullón "montrer l'épi, far la spiga", mot du dialecte de Borgo Erizzo en Dalmatie. Identique à ngallon, v. ci-dessus.

ngurrój "rester irrésolu, hésiter", chez Gazulli "s'arrêter, s'abstenir d'une chose." Avec ngurr "empêcher", ngurój "rendre solide comme la pierre" ngurós "piétrifier" ngurosem "être médusé, frappé d'effroi" un dérivé de gur "pierre". A écarter l'étymologie latine (incurrere) proposée par G. Weigand.

ngalë f. "anguille". Pour des raisons d'ordre phonétique, ni d'origine grecque (ἄγγελος), ni latine (anguilla). Cette dernière aurait abouti en albanais à *ngjelë, à confronter aussi shkëndijë shkëndilë "étincelle" qu'on fait remonter à scintilla. Mot des sources indigènes, d'un *engella, à comparer au nom des illyriens Ἐγγελαίς Ἐγγελάνας Ἐγγελάνας, déjà interprété dans ce sens par Hahn, G. Stier et P. Kretschmer.

ngjat "auprès, auprès de, près de". Mot identique à gjatë "long". A confronter pour le sens roum. lînga "à côté de" et it. lungo du lat. longum, dans Dante Siede lungh' esso, e lungo l'altro pose.

ngjir "enrouer" ngjirem "s'enrouer", aussi qirr qirrem. Ni le rappo-

chement avec le gr. $\kappa\epsilon\sigma\chi\upsilon\sigma$ "sécheresse; raucité, enrouement", ni celui avec le vieux angl. hoarse "enroué" n'a été accepté. G. Meyer a pourtant justement observé que ngjirem résulte de nqirem. Dès lors, ce mot ne peut être séparé de shqirem çirem "crier à tue-tête", qui n'est que la forme réfléchie de shqerr çjerr "déchirer, écorcher, égratigner".

ngjok "battre, frapper" (?), dans ngjoku "il frappa", a été à tort rapproché à klokë "bâton au bout courbé, massue". Comme ngjirem est nqirem, aussi bien ngjok est nqok, un composé de qok "toucher, effleurer; saisir la main de quelqu'un en le saluant". Dans ce même groupe rentre en outre gjokës njokës "diable" en albanais de Grèce, proprement "celui qui saisit" ou bien "celui qui se prend aux cheveux, bretteur". Et de l'albanais du nord janë njykë berret (ou delmet) "les brebis s'accouplent."

nofull f. "mâchoire". Ni comme no-full le proche parent de gr. $\gamma\nu\acute{\alpha}\theta\omicron\varsigma$ et lat. gena "joue" (H. Barić), ni comme *nāpslā la correspondance albanaise de l'ancien ind. snāpayati "il lave", mais comme n-ofull dérivant du lat. offula "petite bouchée." L'élément n- représente la préposition nē, nofull étant formé dans des phrases comme shtie bukën n ofull "je mets le pain dans la mâchoire", où n s'est fondu avec ofull en un seul mot.

nuië f. "grand-mère". Non d'un lat. anulla (recte anula), diminutif de anus "vieille femme", mais une forme abrégée de nūnēlë "marraine; grand-mère maternelle", un dérivé en -lë de nun "parrain".

numër m. "nombre", numëroj, nëmëroj "nombrer". A notre avis, du latin populaire dérivé seulement le verbe nëmëroj, de numerare. Le substantif numër est un mot savant, du lat. (ecclésiastique) numerus ou de l'it. numero.

nun m. "parrain", fém. nunë "marraine", nūnēlë f. "marraine, grand-mère maternelle", nunëri f. "parrainage", nunërohem "se confesser; devenir parrain ou marraine, entrer en relations de parrainage". Un de ces mots d'origine latine de l'albanais, dont la provenance directe (du latin ou à travers le grec) est discutable.

nxit "pousser à, inciter", nxit m. "hâte, célérité", nxitje f. "incitation", nxitōj "se hâter", nxitim m. "hâte". Ne doit être rattaché ni à tērndit trondit "ébranler" (G. Meyer), ni à nxeh "chauffer, rendre brûlant" et à ndex "allumer" (N. Jokl). C'est un composé de cys cyt "agacer, exciter, aiguillonner", et apparenté en outre à gëcit "tenter", guxit guzit "importuner" xëgit même sens, gaxhis "plaisanter", etc.

nytëroj "murmurer, marmotter entre les dents, se plaindre". Probablement un mot onomatopéique.

Nj.

njegull f. "brouillard". Est à rejeter l'opinion commune que njegull, dans l'ancienne littérature nigullë, ensemble avec le roum. negură, remonte à une base latine, à *negula *negla pour nebula, ou à nebula modifié par niger "noir". Au point de vue de l'albanais njegull représente une variante dialectale. Il s'agit du passage du groupe mj à n₁ et à nj dans quelques parlars du nord-est et du centre. Dès lors, le roum. negură repose sur cette forme de l'ancien guëgue, ayant subi peut-être une influence aussi du lat. nebula.

njerkë f. "marâtre", ancienne forme nierkë (F. Blanchus). Du lat. noverca. Pour le masc. njerk la construction d'une base *novercus non attestée, n'est pas nécessaire, s'agissant plutôt d'une forme analogique. Le reflet aroumain du mot latin, notamment le masc. nercu, provient probablement de l'albanais.

ngjicë f. "grand rets de pêche, plongé dans l'eau en position verticale", mot du guègue septentrional. De *ngjit*, guègue *njis njit* "coller", cfr. l'expression (*peshku*) *njit* "le poisson adhère, est collé au rets." Ce verbe apparaît aussi dans *lule njica* "*Viscaria viscosa*", comme l'avait déjà remarqué G. Weigand.

njilë f. "*Tinca vulgaris*, tanche", dérivant probablement d'un *ngjilë*. Au point de vue linguistique cette forme trouverait son explication dans le lat. *anguilla*, mais anguille et tanche sont deux genres de poissons assez différents par la forme.

njollë f. "tache". Ni, comme *ngjollë*, apparenté, hors de l'albanais, à l'anc. haut all. *salō* "trouble, sale" irl. *salach* "sale, malpropre" (N. Jokl), ni, comme "marque, signe", à *njoh* "connaître" (M. Vasmer). Etant donné *ngjyllë* à côté de *ngjollë* et *njollë*, ce mot est un postverbal de *ngjyjej* "teindre", formé à l'aide du suffixe *-llë*. Mot dialectal devenu d'usage général.

njom "mouiller, humecter", i *njomë* "frais, récent, humide, mou, tendre", *njomëz* f. "jet, pousse; jeune garçon, jeune fille". Une forme *nglomë* reportée par *Kristoforidhi* n'existe pas, aussi la comparaison avec le gr. *γλοιός* "glu, gomme; crasse huileuse", vieux sl. *glenъ* "salive, suc, mucus", etc., est insoutenable. En vue de *ngjomë* auprès de *njomë*, et de *ngjymë* "couleur", on doit reconnaître que ce mot repose sur *ngjyjej* "teindre", dont il représente une formation en *-më*.

